



Manuali i Udhëheqësit të Zonës

Hyrje

Faleminderit për dëshirën tuaj për të shërbyer si Udhëheqës Zone në Kampin e Sporteve High Power! Ky udhëzues ka për qëllim t'ju pajisë për këtë rol të rëndësishëm dhe për ta bërë planifikimin tuaj të efektshëm, të lehtë dhe të përshtatshëm! Ky udhëzues përfshin:

- Një përshkrim të rolit tuaj
- Udhëzime planifikimi hap pas hapi me ide sesi ta përdorni këtë manual
- Pesë mësimet krijuese dhe tërheqëse nga Bibla të përshtatura posaçërisht për fëmijët
- Këngë plot energji që do t'i vënë kampistët tuaj në lëvizje!
- Materiale të dobishme, udhëzime dhe shumë të tjera

Ju lutemi rishikojeni këtë udhëzues me kujdes dhe me lutje para se të filloni të luani rolin tuaj këtë verë. Ndërsa përgatiteni, ngazellohuni për mundësinë e mahnitshme që do keni për të ndarë Ungjillin me kampistët dhe familjet e tyre!

Rreth Zonës

Zona është koha e përditshme në grup të madh – vendi për t'u ushqyer frymërisht me të vërtetën e Perëndisë! Gjatë kësaj pjese të ditës së kampit, të gjithë kampistët, trajnerët dhe vullnetarët mbledhen bashkë për katër aktivitete të fuqishme:

Këngët

Këngët e adhurimit me energji të lartë flasin për Jezun Krishtin dhe për dashurinë e tij për ne. Trajnerët dhe kampistët kënaqen duke kënduar dhe duke mësuar lëvizje argëtuese. Shumë shpejt kampistët gjejnë këngët e preferuara dhe janë të ngazëlluar për t'u mbledhur bashkë dhe për të kënduar.

Historia e Sportit dhe Shembulli i Mësimi

Çdo ditë do të tregoni një histori të vërtetë sporti që ilustron temën e përditshme. Pas kësaj do të prezantoni një mësim ndërveprues që përforcon temën e ditës duke përdorur objekte dhe njerëzit pranë jush.

Mësimi biblik

Këto mësimet përdorin përmbajtje krijuese dhe të përshtatshme për moshën për t'iu mësuar kampistëve se kush është Perëndia dhe sesi mund ta njohin Atë personalisht përmes Jezut Krishtin. Çdo mësim i përditshëm ndërton mbi konceptet e prezantuara në ditët pararendëse. Ditën e katërt të kampit trajnerët do të rishikojnë të gjitha mësimet dhe do prezantojnë Ungjillin e plotë.

Vargu Tematik i Fuqisë

Kampistët recitojnë dhe mësojnë përmendësh Vargun Tematik për javën. Mësimi përmendësh është një karakteristikë kyçe e Kampit të Sporteve High Power. Fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese. Kur fëmijët e mësojnë përmendësh Shkrimin ai ruhet në zemrat dhe mendjet e tyre dhe praktikohet përgjatë jetës.

Roli dhe Përgjegjësitë

Ju jeni zgjedhur si Udhëheqës i Zonës për shkak të aftësisë tuaj për të ndarë të vërtetën Biblike me fëmijët, krijimtarisë, entuziazmit, organizimit dhe aftësive të udhëheqjes së ekipit.

Si Udhëheqës i Zonës ju jeni më së pari përgjegjës për:

- Mbikëqyrjen e planifikimit dhe udhëheqjen e elementeve të programit të Zonës
- Rekrutimin, drejtimin dhe takimin me ekipin e vullnetarëve të Zonës
- Komunikimin me Drejtorin e Kampit, trajnerët, dhe të tjerët rreth Zonës dhe për rolet që ata do të luajnë.

Vullnetarët që do ju nevojiten për Zonën do të varen nga programi që keni planifikuar. Minimalisht, do të keni nevojë për një udhëheqës adhurimi (që i udhëheq fëmijët në këngë dhe mësimin përmendësh të vargut) dhe një mësues Bible. Vullnetarët e tjerë mund të përfshijnë muzikantët, teknikët e zërit dhe videos, apo një ekip të skenës. Disa mësimet Biblike kërkojnë përfshirjen e trajnerëve dhe vullnetarëve por këto role kërkojnë pak ose aspak përgatitje.

Lista e Kontrollit të Planit të Zonës

Tre deri gjashtë muaj para fillimit të kampit:

- ☐ Lexoni Manualin e Udhëheqësit të Zonës dhe filloni të planifikoni programin e Zonës tuaj.
- ☐ Dëgjoni këngët e lavdërimit të Zonës. (Fjalët janë të përfshira në CD)
- ☐ Vendosni me Drejtorin e Kampit se cili është vendi më i mirë për të bërë aktivitetet e Zonës.
- ☐ Vendosni se cilët elemente të programit do të udhëhiqni ju dhe cilat do t'ua delegoni të tjerëve.
- ☐ Punoni me Drejtorin e Kampit për të rekrutuar një Ekip Vullnetarësh të Zonës një deri dy muaj para fillimit të kampit.
- ☐ Filloni të takoheni me ekipin e Zonës për t'u përgatitur dhe praktikuar elementet e programit.
- ☐ Filloni të grumbulloni materialet për aktivitetet e Zonës (zbukurime, sistem zëri, materiale për mësimet, et.).
- ☐ Takohuni me drejtorin e kampit për ta mbështetur me materiale ose planifikim.

Një deri dy javë para fillimit të kampit:

- ☐ Rishikoni detajet e fundit me Drejtorin e Kampit.
- ☐ Informojeni Drejtorin e Kampit për ndonjë nevojë të fundit.
- ☐ Merrni pjesë në të gjitha takimet e trajnimit të vullnetarëve të kampit.
- ☐ Komunikoni me Drejtorin e Kampit, trajnerët dhe të tjerët rreth aktiviteteve të Zonës dhe për mënyrat sesi do të keni nevojë për përfshirjen e tyre gjatë Zonës.
- ☐ Përgatitni dhe zbukuroni Zonën sa më shumë që të jetë e mundur që më përpara.
- ☐ Ejani herët bashkë me vullnetarët për të bërë gati dhe zbukuruar Zonën.
- ☐ Sigurohuni që të gjithë vullnetarët dhe trajnerët të jenë të pranishëm për aktivitetet që u janë caktuar në Zonë.
- ☐ Informoni Drejtorin e Kampit për ndonjë nevojë për Zonën dhe komunikoni pyetjet dhe problemet.
- ☐ Praktikoni aktivitetet e Zonës me ekipin derisa kampistët të vijnë në Zonë.
- ☐ Udhëhiqni/kryeni elementet e programit të Zonës me energji dhe entuziazëm.
- ☐ Gjatë Kohës së Ekipit jini në dispozicion për t'iu përgjigjur ndonjë pyetjeje që trajnerët apo kampistët mund të kenë rreth dramës apo mësimit të Biblës apo pyetje që kanë lidhje me diskutimin.
- ☐ Siguroni materiale mbështetëse për trajnerët gjatë Kohës në Ekip.
- ☐ Ndhimjoni vullnetarët e tjerë të kampit sipas nevojës pasi të kenë përmbyshur përgjegjësitë e Zonës (p.sh. ndihmoni me tryezat e regjistrimit, organizimin e fushës, et.).
- ☐ Pastroni Zonën dhe bëjeni gati për ditën tjetër.
- ☐ Merrni pjesë në takimet e vullnetarëve.
- ☐ Vlerësoni aktivitetet e Zonës dhe identifikoni zona që kanë nevojë për përmirësim pas përfundimit të kampit.

Pasi të përfundojë kampi:

- ☐ Përmbyshni rolin tuaj në organizimet e mbylljes së kampit dhe në punën pasuese si t'ju udhëzojë Drejtori i Kampit.

- ☐ Pastroni Zonën dhe largoni pajisjet.
- ☐ Grumbulloni materialet e tepërta që mund të përdoren dhe vendosini në dhomën e materialeve të kishës tuaj.
- ☐ Ktheni pajisjet apo zbukurimet që i keni marrë hua.
- ☐ Sendet e harruara nga kampistët vendosini në këndin e sendeve të humbura.

Orari i Zonës

Drejtori i kampit tuaj do t'ju tregojë orarin e Zonës. Koha totale në Zonë çdo ditë është afërsisht 60 minuta, duke përfshirë edhe kohën e mirëseardhjes. Sigurohuni që të lidheni me Drejtorin e Kampit për të mësuar se kur janë caktuar Zonat #1-4 për kampin tuaj. Më poshtë janë kohët e Zonave të ndryshme dhe përbërësit e secilës prej tyre.

Zona #1 - Mirëseardhja dhe Prezantimi

Kjo kohë normalisht është në fillim. Kampistët janë të gjithë bashkë dhe kjo kohë përfshin këngë, një prezantim të temës së ditës, dhe disa aktivitete të tjera argëtuese. Kjo është gjithashtu kohë e mirë për të punuar me vargun tematik si grup. Nganjëherë kjo kohë quhet Para-Loja apo Nxemja.

Zona #2 - Historia e Sportit dhe Shembulli i Mësimi

Historia e sportit dhe shembulli i mësimi janë pjesa e parë e ditës. Fëmijët janë të gjithë së bashku dhe në varësi të kampit tani haet diçka e lehtë ose është ngrënë tashmë. Janë kënduar dy tre këngë dhe është zhvilluar historia e përditshme e sportit dhe shembulli i mësimi. Mund të përfshini ndonjë lloj konkursi dhe një rikujtim të temës. Ky është një moment shumë i mirë për të punuar me mësimin përmendësh të vargut. Nganjëherë kjo quhet Pjesa e Parë.

Zona #3 - Historia e Biblës

Kjo është koha kryesore e mësimi të Biblës çdo ditë. Koha e Biblës vjen menjëherë pas Zonës #2 ose afër fundit të ditës. Për t'i ndihmuar fëmijët të bëhen gati për Historinë e Biblës luani një këngë më të qetë. Nganjëherë kjo kohë quhet gjithashtu Koha e Biblës.

Zona #4 - Përmbledhja dhe Mbyllja

Kjo Zonë ndodh në fund të çdo dite. Të gjithë mbledhen bashkë, rikujtojnë temën e ditës dhe u jepet mundësia të dëgjojnë një këngë të fundit ndërsa bëhen gati të largohen. Kjo është gjithashtu një kohë shumë e mirë për të punuar si grup me Vargun Tematik. Nganjëherë kjo kohë quhet Pas-Loja.

Kampi juaj mund të përhijë vetëm disa nga kohët e Zonës ose mund të përdorni emra të tjerë. Ju sugjerojmë që të planifikoni për çdo kohë. Ky manual ka disa nga pjesët kryesore të nevojshme për çdo Kohë Zone; megjithatë ju duhet të siguroheni që të keni një prezantues që t'i mbajë gjërat në lëvizje gjatë ditës.

Mjediset dhe Përgatitja e Zonës

Mjediset e Zonës

Hapësira për aktivitetet e Zonës duhet të jetë mjaft e madhe që të gjithë kampistët dhe trajnerët të ulen dhe qëndrojnë rehatshëm, si dhe për të bërë këngët me lëvizje pa u përplasur me personin përkatës. Kjo mund të jetë në mjedis të mbyllur në një sallë kishë, palestër, sallë miqësie apo ndonjë dhomë tjetër të madhe.

Aktivitetet e Zonës mund të bëhen edhe në një hapësirë jashtë. Nëse jeni në ambient të hapur konsideroni vendosjen e një tende për të mbrojtur kampistët nga shiu dhe dielli ose planifikoni një mjedis tjetër brenda për ditët me shi. Kini parasysh teknologjinë dhe ndihmat vizuale që planifikoni të përdorni gjatë aktiviteteve të Zonës. Vendosni nëse këto gjëra mund të zhvillohen jashtë.

Përgatitja e Zonës

Vendosni radhë me karrige për kampistët dhe trajnerët ose mund të ulen edhe në dysheme mbi copa tapeti ose në bar (nëse jeni jashtë). Pastroni një zonë të madhe për skenën e cila të jetë e dukshme nga të gjithë personat në audiencë. Mendoni për nevojat tuaja teknike. Nëse keni një grup të madh ose po e zhvillon Zonën jashtë do të keni nevojë për sistem zëri në mënyrë të veçantë për mësimet Biblike. Vendosni një sistem të mirë zëri dhe mjaft mikrofona për personat që do të jenë në skenë. Për siguri, ngjitini të gjithë kabujt në dysheme duke

përdorur ngjitës të fortë. Do të keni nevojë edhe për një mënyrë për të luajtur këngët nga CD-ja si dhe disa altroparlantë për të pasur volum në muzikën e lavdërimit në Zonë. Një mundësi mund të jetë që të përdorni edhe një ekran të madh ku të projektoni fjalët e këngëve apo imazhet që kanë të bëjnë me mësimin, ose për të treguar pjesë videosh nga java e kampit.

Zbukurimi i Zonës

Edhe pse zbukurimet nuk janë të nevojshme, ato mund të përforcojnë temën dhe gjithë përjetimin e kampit. Sigurohuni që të përfshini të gjitha sportetet e ndryshme që do luani dhe bëjini gjërat sa më argëtuese.

Ide dhe Materiale për Zonën

- Fëmijët reagojnë ndaj ngazëllimit që ju krijoni. Bëjeni sa më argëtuese atmosferën e Zonës, të gjallë dhe me ritëm që nga sekondat e para kur fëmijët hyjnë në zonë!
- Besimi i një trajneri është një shembull i fuqishëm për kampistët. Inkurajojini trajnerët të marrin pjesë me entuziazëm gjatë këndimit të këngëve, të ndërveprojnë me kampistët gjatë aktiviteteve të mësimin dhe t'i ndihmojnë ata të gjejnë pjesët e Biblës gjatë mësimin.
- Ruani kontrollin e grupit dhe të disiplinojnë duke u siguruar që trajnerët të ulen apo qëndrojnë me ekipet e tyre për t'i ndihmuar anëtarët e tyre që të jenë të fokusuar. Për t'i mbajtur fëmijët të fokusuar më e mira është ta organizoni Zonën në mënyrë që ekipet e moshave më të vogla të hyjnë të parët dhe të ulen më afër skenës. Nëse një trajner po has vështirësi në ndërveprimin me kampistët, kontaktoni Drejtorin e Kampit apo Kryetrajnerin.
- Fëmijët mendojnë dhe veprojnë ndryshe në mosha të ndryshme! Sigurohuni që të jepni mësim duke pasur ndërmend karakteristikat e zhvillimit të fëmijëve. Ndajini kampistët në grupe sipas moshës për mësimin e Biblës në mënyrë që ta përshtatni mesazhin me nivelin e moshës së tyre.
- Fëmijëve iu pëlqen të shohin veten në ekran të madh! Caktoni një vullnetar që të bëjë inçizime me kamera çdo ditë të kampit dhe shfaqini në një ekran të madh ndërsa kampistët hyjnë në Zonë.
- Hyni në botën e kampistëve tuaj! Vështrojin gjatë javës së kampit. Për çfarë flasin? Çfarë fjalësh përdorin? Cilat përjetime nga dita e kampit duket se i ndikojnë? Përfshini gjuhën dhe përjetimet e tyre sa më shumë të jetë e mundur në mësimet dhe dramat tuaja.
- Përdorni mësimin aktiv. Fëmijët mësojnë më mirë kur përfshihen. Mënjanoni përdorimin ekskluziv të teknikave "mësuesi thotë" si për shembull leksionin. Përdorni një larmi metodash që përfshijnë fëmijët që flasin, shohin, dhe lëvizin. Mësimet në këtë Manual ofrojnë disa mundësi të ndryshme.
- Mbajini gjërat në lëvizje! Sigurohuni që t'i keni materialet gati. Jini gati për të lëvizur në fazën tjetër të mësimin para se fëmijët të mërzhiten me fazën ekzistuese. Kohëzgjatja minimale e vëmendjes së një fëmije është rreth një minutë për çdo vit të moshës së tyre, prandaj një gjashtë vjeçar do jetë në gjendje të kushtojë vëmendje për të paktën gjashtë minuta. Shkurtojini aktivitetet e Zonës nëse keni shumicë kampistësh të vegjël.
- Vlerësoni synimet e mësimin tuaj. Çdo mësim ofron synime të sugjeruara për kampistët. Shikoni kampistët gjatë mësimin për t'u siguruar që këto synime do të përmbushen. Thuajuni trajnerëve që të kenë në mendje këto synime gjatë Kohës në Ekip dhe pjesëve të tjera të ditës. Punoni me Drejtorin e Kampit për të vlerësuar efektivitetin e Zonës.

Manuali i Udhëheqësit të Zonës

Ky kurrikulum është shkruar në format dorëshkrimi në mënyrë që ju dhe vullnetarët e tjerë të keni një ide të qartë sesi ta zhvilloni Zonën. Elementet e ndryshme dhe funksionet e tyre janë radhitur më poshtë. Për një pamje të përgjithshme të gjithë javës ju lutemi shihni faqen 9.

Lista e këngëve

Çdo ditë ka gjashtë momente për të kënduar këngët. Ja ku është rendi i sugjeruar:

- Këngët 1 dhe 2 këndohen gjatë Zonës #1 ose Nxemjes
- Këngët 3 dhe 4 këndohen në Zonën #2 ose me historinë e sportit
- Kënga 5 këndohet para Kohës së Biblës në Zonën #3
- Kënga 6 duhet të këndohet gjatë Zonës #4 ose në kohën e mbylljes

Jeni të lirë t'i ndryshoni këngët ose t'i luani ato në momente të ndryshme. E kemi shtuar këtë sugjerim që të dini se çfarë funksionon më mirë.

Dita 1

1. Brave
2. High Power
3. Inside My Heart
4. Nothing Better
5. 10,000 Reasons
6. I Believe in Jesus

Dita 2

1. I Believe in Jesus
2. Brave
3. High Power
4. Movin' Me
5. 10,000 Reasons
6. Shine

Dita 3

1. Inside My Heart
2. Shine
3. Nothing Better

4. Movin' Me
5. 10,000 Reasons
6. Brave

Dita 4

1. I Believe in Jesus
2. Shine
3. Movin' Me
4. High Power
5. 10,000 Reasons
6. Inside My Heart

Dita 5

1. Inside My Heart
2. High Power
3. I Believe in Jesus
4. Nothing Better
5. 10,000 Reasons
6. Brave

Nxemja

Kjo pjesë e kurrikulumit i jep prezantuesit temën e ditës dhe një përshkrim të shkurtër për ta prezantuar në mënyrë argëtuese dhe ngazëlluese. Kjo nuk trajton çdo aspekt në të cilin do të përfshihet prezantuesi. Thjesht fokusohet në një mënyrë të thjeshtë për të prezantuar temat e ditës dhe për të filluar kampin. Prezantuesi duhet të përfshihet gjithashtu në të gjitha kohët e tjera të Zonës.

Historia e Sportit

Kjo është historia e përditshme e sportit që tregohet gjatë Kohës së Zonës #2. Historia duhet treguar në një mënyrë argëtuese dhe ngazëlluese në mënyrë që fëmijët ta kuptojnë temën e ditës. Edhe pse historia thjesht mund të lexohet nga faqet më e mira është që të merren idetë dhe temat nga historia dhe të përvetësohen në mënyrë që t'i komunikoni në mënyrë argëtuese dhe ngazëlluese për grupin tuaj.

Shembulli i Mësimit

Kjo bëhet çdo ditë gjatë Kohës së Zonës #2 për të përforcuar temën në një mënyrë të veçantë për kampistët. Shembujt e Mësimit janë shumë të thjeshtë dhe nuk kërkojnë shumë përgatitje. Udhëzimet dhe përshkrimi janë radhitur në këto pjesë.

Historia nga Bibla

Çdo ditë ka nga një histori nga Bibla që do prezantohet gjatë Konkursit të Biblës. Edhe pse mësuesi i Biblës mund ta lexojë atë direkt nga libri, përfshirja e kampistëve i bën historitë të marrin jetë. Në çdo mësim, ka disa

vargje që duhen lexuar. Rekomandohet shumë që këto vargje të lexohen para kampistëve direkt nga Bibla. Ky është përforsim pamor që vargjet vijnë nga Bibla.

Mësimi përmendësh i Vargut

Ja tek keni vargun për këtë vit me ide për lëvizjet.

Gjoni 16:33 (**s'ka lëvizje**)

"Jua kam thënë (**vendosni gishtin mbi buzë dhe lëvizeni përpara**)

këto gjëra (**vendoseni pëllëmbën e hapur para gjoksit dhe pastaj shtrijeni përpara**),

që ta keni paqen (**bëni shenjën për paqe**)

në mua; (**tregoni drejt qiellit**).

në botë (**bëni një rreth me të dyja duart**)

do të keni mundime (**tundni kokën anash duke e mbajtur me duart**).

por merrni zemër (**vendosni dorën grusht mbi gjoks, shihni drejt horizontit**),

unë (**tregoni drejt qiellit**)

e munda (**mblidhni muskujt me të dy krahët**)

botën (**bëni një rreth me të dyja duart**)."

Triumfo

PASQYRA E JAVËS

1	2	3	4	5
Ji i Mësueshëm	Ji Guximtar	Ji i Përulur	Ji Besues	Ji Shpresues
HISTORIA E BIBLËS				
Danieli dhe shokët e tij Danieli 1-2	Furra e Zjarrtë Danieli 3	Poshtërimi i Nebukadnesarit Danieli 4	Gropa e Luanëve Danieli 6	Ëndrra / Përmbledhje Danieli 7
PIKA KYÇE				
Perëndia është trajneri më i mirë për ju dhe ekipin tuaj.	Perëndia na jep guxim për të qëndruar për të drejtën.	Perëndia na kërkon të jemi të përulur dhe të ecim me Të.	Perëndia do na shpëtojë përgjithmonë kur i besojmë Atij.	Perëndia na ka dhënë të gjithëve ne shpresë për të ardhmen.
HISTORIA E PERËNDISË				
Perëndia të krijoj që të ishe në ekipin e Tij	Jezusi gjithmonë bën gjënë e duhur	Perëndia na fal kur nuk bëjmë gjënë e duhur	Perëndia ka fuqi për t'ju shpëtuar	Shpresa e Perëndisë fillon tani dhe vazhdon në të ardhmen.

DITA NJË

Pasqyra e Ditës

TEMA: Ji i mësueshëm

HISTORIA BIBLIKE: Danieli dhe shokët e tij (Danieli 1-2)

PIKA KYÇE: Perëndia është trajneri më mirë për ju dhe ekipin tuaj

HISTORIA E PERËNDISË: Perëndia ju krijoi të jeni në ekipin e Tij

Lista e Këngëve

1. Brave
2. High Power
3. Inside My Heart
4. Nothing Better
5. 10,000 Reasons
6. I Believe in Jesus

Nxemja

Përshendetje! Mirë se vini në Kampin e Sporteve Triumfo! Jemi shumë të ngazëlluar që jeni bashkuar me ne për këtë javë fantastike. Për këtë javë kemi planifikuar shumë argëtim ku përfshihen edhe sportet! Kush është i ngazëlluar që do luajë sport? Shumë mirë! Sportet nuk janë gjëja e vetme argëtuese që do mësojmë këtë javë. Për të na ndihmuar që të mësojmë kemi disa gjëra të cilat duhet t'i shohim para se të fillojmë.

(Flisni për hapësirat e kampit, kufijtë e kampit, si të sillemi në kamp, etj.)

Një nga gjërat e mia të preferuara rreth kampit është që mësojmë për Perëndinë. Kush mund të më tregojë diçka që e dini për Perëndinë?

Perëndia është madhështor. Ai na krijoi. Ai dërgoi Birin e Tij Jezusin të vdesë për ne. Perëndia është i gjithëfuqishëm dhe i gjithëdijshëm. Perëndia është FUQIA MË E MADHE. Bashkë me Të ne mund të triumfojmë mbi çdo vështirësi! Në fakt, kjo është tema jonë për këtë javë. Triumfo. A mund të më thotë dikush se çfarë do të thotë të triumfosh? (Dëgjoni disa prej përgjigjeve)

Po, të triumfosh do të thotë të kesh sukses në trajtimin e një problemi apo vështirësie. Prandaj, cilat janë disa gjëra që ju është dashur t'i kaloni dhe të triumfoni? (Dëgjoni disa prej përgjigjeve) Këto janë përgjigje shumë të mira!

Këtë javë kemi një varg nga Bibla të cilin do ta mësojmë së bashku. Ky është vargu Gjoni 16:33 "Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!"

Jezusi i tha këto gjëra ndërsa ishte këtu në tokë. Qysh atëherë Ai po na fliste ne! Sa interesante. Edhe mënyra sesi Jezusi na ndihmoi të triumfonim mbi problemin tonë me mëkatën dhe mënyrë si ai ndikon jetën tonë! Këtë javë do të shohim jetën e Danielit dhe sesi Perëndia na tregon të vërtetën përmes historive të Biblës.

Çdo ditë do kemi një temë që flet se çfarë kërkohet për të triumfuar mbi problemet dhe vështirësitë. Sot është dita jonë e parë – dhe meqë jemi duke folur për të mësuar – më kujtohet tema jonë e parë: Për të triumfuar duhet të jeni të mësueshëm. Të jesh i mësueshëm do të thotë të dëgjosh atë që thotë trajneri dhe të përpiqesh ta zbatosh në realitet.

E njëjta gjë vlen edhe për jetën tonë. Nëse nuk jemi të mësueshëm a do jemi në gjendje të triumfojmë mbi kohët e vështira kur ato të vijë? JO! Nëse duam të triumfojmë mbi problemet apo vështirësitë, atëherë duhet të jemi të mësueshëm.

Prandaj... Cila është tema jonë për gjithë javën? (TRIUMFO!) Cila është? (TRIUMFO!)

Çfarë kemi nevojë të bëjmë për të triumfuar? TË JEMI TË MËSUESHËM! E keni kapur shumë mirë! Ndërsa presim të stërvitemi në sportin tonë le të përpiqemi të jemi të mësueshëm, në mënyrë që të mësojmë edhe më tepër sesi të luajmë. Pastaj më vonë do takohemi me Danielin dhe do mësojmë se sa e rëndësishme është të zgjedhim trajnerin e duhur dhe ta dëgjojmë. Do t'ju jap një ide... Perëndia është trajneri më i mirë për ne!

HISTORIA E SPORTIT

Sa prej jush mendoni se jeni shumë të shpejtë? Ka disa sporte që janë krejtësisht të fokusuara tek të qenët personi më i shpejtë. Cilat janë disa sporte të tilla? (Përgjigjet mund të përfshijnë: Vrapin, notin, garat me makina, skitë, etj.)

Një nga sportet që fokusohet vetëm tek shpejtësia është vrapin. Vrapurit e shpejtë që konkurojnë në gara me distanca të shkurtra mund të vrapojnë jashtëzakonisht shpejt dhe ta mbarojnë garën në një kohë shumë të shkurtër. Për shembull, në lojërat e fundit Olimpikë sportistët që vrapuan garën e 100 metërshit (sa gjatësia e një fushe futbolli) e mbaruan atë në më pak se 10 sekonda! Kjo po që është shpejtësi!

Historia e sotme e sportit bën fjalë për një vrapues të quajtur Eric Liddell. Eric ka jetuar para shumë vitesh dhe ai madje pati një fillim goxha interesant në jetën e tij. Ai në fakt lindi në Kinë nga dy prindër Skocezë. Prindërit e tij kishin shkuar në Kinë për t'iu treguar njerëzve për Perëndinë. Ata ishin misionarë dhe i mësuan Erikut rëndësinë e të pasurit të Perëndisë si trajnerin e tij. Eriku mësoi të dëgjonte Perëndinë dhe jo njerëzit përreth tij.

Ndërsa u rrit Eriku luante regbi dhe vraponte. Ai ishte sportist i talentuar dhe shkëlqeu në të dyja këto sporte. Por kur po afroreshin lojërat olimpikë të Athinës në vitin 1924 Eriku hoqi dorë nga regbia për t'u fokusuar tek vrapimi, në mënyrë të veçantë tek gara e tij e preferuar, 100 metërshi.

100 metra janë sa gjatësia e një fushe futbolli. Eriku ishte shumë i zoti në këtë garë. Ai ishte trajnuar, kishte praktikuar dhe e kishte bërë këtë garë për disa vite. Prandaj, ai ishte i ngazëlluar që do të garonte me sportistët më të mirë të botës dhe pritej që do të fitonte medaljen e Artë.

Pastaj u shpall orari i garave. Eriku kishte një problem. Para shumë kohësh Eriku kishte vendosur që të mos vraponte të Dielave. Ai e kishte veçuar atë ditë për t'u çlodhur dhe për t'u fokusuar tek Perëndia! Fatkeqësisht garën e 100 metërshit e kishin caktuar për ditën e Dielë. Eriku u gjend para një zgjedhjeje të vështirë. Ai ose mund të shkonte kundër trajnimit që Perëndia i kishte dhënë dhe të vraponte të Dielë ose mund të hiqte dorë nga ëndrra e jetës së tij për të vrapuar garën e 100 metërshit në lojërat Olimpikë.

Çfarë mendoni se vendosi Eriku? Ai zgjodhi të bindej dhe të zbatonte trajnimin që i kishte dhënë Perëndia dhe të mos vraponte ditën e Dielë! Ishte shumë e mundur që ai kishte hequr dorë nga ëndrra e tij për të fituar medaljen e artë. Por, për shkak se Eriku ishte vrapues shumë i mirë kishte pasur mundësi të kualifikohej edhe për një garë tjetër në Athinë. Kishte të ngjarë që ai nuk do ta fitonte garën ashtu si do të fitonte 100 metërshin.

Kjo garë ishte katër herë më e gjatë se gara më e mirë e Erikut. Gara e 400 metërshit është një vrapim i plotë përreth stadiumit. Kjo është një garë e vështirë. Kur vrapon garën e 100 metërshit vrapon me sa shpejtësi që mundesh. Nuk shqetësohesh për ritmin apo për të ruajtur energjitë për fundin e garës sepse kjo është garë e shkurtër. Eriku nuk ishte mësuar me garën e gjatë dhe duhej të mësonte një mënyrë krejt të re garimi para lojërave Olimpikë. Ai u stërvit fort me trajnerët nga Skocia për ta ndihmuar që të mësonte këtë stil të ri. Nëse nuk do ishte i gatshëm të mësonte a do dilte mirë në garë? JO! Ai kishte nevojë të ishte i mësueshëm. Edhe kur vrapoi për t'u kualifikuar në lojërat Olimpikë, Eriku mezi u kualifikua për 400 metërshin! Megjithatë, ai arriti deri tek gara e fundit.

Eriku erdhi tek pika e nisjes së garës. U dha sinjali dhe Eriku u lëshua në vrap... kaloi 100 metra, po afrohej tek 200 metra, tek gjysma e garës Eriku u lëshua në një sprint të plotë!

Kjo i habiti vrapuesit e tjerë. Askush nuk lëshohej në sprint deri sa të kishin kaluar të paktën 300 metra! Eriku u nis herët. Çfarë po mendonte? Disa nga vrapuesit e tjerët filluan të kapnin ritmin e tij. Ata e arritën Erikun dhe u përpoqën ta kalonin, por tani arritën në 100 metrat e fundit të garës.

Eriku vazhdoi sprintin sikur të ishte duke vrapuar garën e tij të preferuar atë të 100 metërshit! Ndërsa vrapuesit po i afroreshin vijës së finishit Eriku u shkëput para tyre dhe e fitoi garën! Jo vetëm që e fitoi garën me 0,8 sekonda avantazh, por në të njëjtën kohë vendosi edhe një rekord të ri botëror!

Ju inkurajoj të mësoni më tepër rreth Eric Liddell dhe jetë së tij. Pas lojërave Olimpikë, Eriku vazhdoi të kishte Perëndinë si trajnerin e tij dhe u kthye në Kinë si misionar.

Sot po flasim sesi duhet të jemi të mësueshëm. Eric Liddell jo vetëm që ishte i mësueshëm në vrapim por ai e dinte që trajneri më i rëndësishëm ishte Perëndia! Ai dëshironte të ndiqte planin e Perëndisë për jetën e tij dhe këtë e bëri duke ndjekur atë që Perëndia i kishte kërkuar të bënte. Ai e kaloi zhgënjimin që duhet të ketë ndjerë kur iu desh të zgjidhte mes bindjes ndaj Perëndisë dhe ndjekjes së ëndrrës së jetës së tij. Duke dëgjuar Perëndinë dhe duke i dhënë Atij lavdi, Eric Liddell ishte në gjendje të triumfoje duke qenë i mësueshëm!

Më vonë do të dëgjojmë për një burrë të quajtur Daniel i cili gjithashtu zgjodhi atë që dëshironte Perëndia në vend të asaj që iu ofrua atij!

SHEMBULL MËSIMI

Përgatitja: Përdorni një fanellë. Duhet të flisni me trajnerin bashkëpunues që më parë për këtë mësim Ndërsa ai e “ndihmon” kampistin, duhet ta ndihmojë atë ta veshë fanellën sikur të ishin një palë pantallona të shkurtra. Kjo do tregojë sesi një trajner i keq krijon konfuzion dhe iu jep njerëzve arsye për të mos pasur besim tek ai.

Mirë, gjithë këtë javë do flasim se çfarë kërkohet për të triumfuar. A mund të më thote dikush se çfarë do të thotë të triumfosh ndaj diçkaje? Shumë mirë! Do të thotë të kesh sukses në trajtimin e një problemi apo vështirësie. Sot do të flasim për një prej aftësive që nevojitet për të triumfuar mbi gjërat, e cila mund të jetë e vështirë apo madje mund të duket e pamundur. Sot do të flasim për të qenët i mësueshëm. Në historinë e sportit dëgjuam për Eric Liddell dhe për dëshirën e tij për t’u fokusuar tek Perëndia si trajneri i tij! Ai hoqi dorë nga gara e tij e preferuar në mënyrë që të ruante përkushtimin e tij ndaj Perëndisë. Më vonë do të prezantohemi me një person historinë e vërtetë të të cilit e gjejmë në Bibël. Emri i tij është Daniel. Ai gjithashtu u mbështet tek Perëndia si trajneri i tij!

Një nga mënyrat kryesore sesi mund të jemi të mësueshëm është që të sigurohemi që po dëgjojmë trajnerin e duhur. Për të demonstruar sa e rëndësishme është që të zgjedhim trajnerin e duhur kam nevojë për një trajner dhe një prej jush që të më ndihmojnë. **(Zgjidhni një nga kampistët me moshë mesatare).** Mirë, trajner _____ do t’i japë disa udhëzime (emri i kampistit) në mënyrë që ta veshë këtë fanellë sa më shpejt të jetë e mundur. Unë do mat kohën, kurse detyra juaj është t’i inkurajoni ndërsa përpiqen ta veshin fanellën.

Dakord... gati, fillo.

Ndërsa trajneri e mban fanellën sikur të ishin pantallona të shkurtra në të cilat të hyjë kampisti do të ketë konfuzion. Kampisti mund të qëndrojë i shtangur. Kjo është në rregull. Kampisti mund të përpriqet të dëgjojë trajnerin: kjo do të krijojë një skenë për të qeshur, edhe kjo është në rregull. Sigurohuni që trajneri të tregohet këmbëngulës që kampisti të futet në fanellë.

Pas pak kohe, kërkojini kampistit që të mos përpriqet më.

Në rregull, a mendoni se trajneri _____ po jepte këshillë shumë të mirë në këtë rast? Jo! Ai/ajo po shkaktonte konfuzion dhe nuk kishte shumë kuptim. Ai/ajo madje nuk i ndoqi udhëzimet e personit që krijoi fanellën! Prodhuesi i fanellës është e qartë që dëshironte që ata ta vishnin fanellën nga koka. Për këtë arsye është PJESA E HAPUR E KOKËS!

Fatmirësisht, ne kemi një trajner që na krijoi! Perëndia na krijoi dhe na dha udhëzime! Ai nuk shkaktoi konfuzion... Ai na dha Biblën, e cila na udhëzon dhe na tregon sa shumë Ai na do dhe sesi ta jetojmë jetën tonë më mirë! Ne kemi një Perëndi të mahnitshëm si trajnerin tonë!

Ma jepni fanellën. Le ta shohim me kujdes dhe të mësojmë sesi është krijuar ajo nga prodhuesi që të përdoret. Ndoshta tek kjo duhet të fokusohemi.

A mund të na ndihmoni? Si duhet ta veshë (emri i kampistit) këtë fanellë? Nga koka e tij apo saj, hapja e mesit është për kokën dhe ato anësoret për krahët, apo jo? Mirë, gati, fillo... UAU! Kjo ishte shumë më shpejt; një duartrokkitje të fortë për (emri i kampistit) ndërsa ai/ajo ulet në vend.

Funksionoi shumë herë më mirë kur u fokusuam tek mënyra sesi prodhuesi dëshiron që ta veshim fanellën.

Ashtu sikurse Perëndia na krijoi në mënyrë të caktuar dhe ne duhet ta dëgjojmë Atë si trajnerin tonë! Më vonë sot në historinë tonë do të shohim që Perëndia i dha Danielit dhe miqve të tij udhëzime shumë të mira dhe specifike për mënyrën sesi duhej të kujdeseshin për trupat e tyre. Edhe kur dikush u përpoq t'i ngatërronte ata qëndruan pas asaj që dinin dhe Perëndia u siguroi që ata t'i mposhtnin pengesat para tyre!

HISTORIA BIBLIKE

Danieli dhe Miqtë e tij (Danieli 1-2)

Përshëndetje kampistë! Mirë se erdhët nga koha e lojës! A u kënaqët duke mësuar më shumë për sportet tuaja sot? Shkëlqyeshëm! Këtë kohë e kemi veçuar për të mësuar më tepër rreth asaj që Fjala e Perëndisë (Bibla) na thotë sesi mund të kemi një marrëdhënie me Perëndinë. Kush prej jush di ndonjë histori nga Bibla? (Dëgjoni disa nga përgjigjet)

Po, ato janë disa prej historive të Biblës: Jona dhe peshku i madh, Davidi dhe Goliathi, Kopshti i Edenit, Arka e Noeut... Tani, këto histori tingëllojnë si shumë të pabesueshme, apo jo? Gjëja më e mirë rreth këtyre historive është që secila prej tyre është e vërtetë. Çdo histori në Bibël është e vërtetë. Bibla është fjala e Perëndisë për ne dhe ne mund t'i besojmë asaj që na thotë ajo.

Këtë javë do të mësojmë për një burrë në Bibël i cili quhet Daniel. Do të mësojmë sesi me fuqinë e Perëndisë ai fitoi mbi shumë probleme dhe vështirësi në jetën e tij. Sot do të mësojmë sesi Danieli fitoi mbi një vështirësi vërtetë të madhe në jetën e tij dhe u mbështet tek trajneri i tij Perëndia. Kur ishte fëmijë Danielit i ndodhën disa gjëra të vështira të cilat i shkaktuan shumë trishtim. Megjithatë, me ndihmën e Perëndisë Danili i mposhti ato.

Imagjinoni sikur t'ju shkatërrojnë shtëpinë, t'ju vrasin disa nga familja dhe miqtë tuaj, dhe pastaj t'ju çojnë në një vend të largët dhe të çuditshëm. Si do të ndiheshit ju? Kjo është saktësisht situata në të cilën u gjend Danieli. E trishtueshme apo jo?

Një person tjetër në histori është Mbreti i Babilonisë, Nebukadnesari. Mbreti Nebukadnesar ishte një mbret shumë i pushtetshëm që para shumë kohësh kishte pushtuar disa vende dhe tani kontrollonte shumë popuj. Një nga këto kombe të pushtuara prej tij ishte edhe Izraeli. Kur Nebukadnesari pushtonte një vend sigurohej që ata të mos kishin mundësi të luftonin më kundër tij dhe pastaj merrte shumë nga populli robër në Babiloni. Ka të ngjarë që Danieli të ishte 12 apo 13 vjeç kur e morën rob, por ai ishte veçuar për një detyrë të veçantë: ai po edukohej që një ditë të shërbente si një nga këshilltarët e mbretit.

Po, me të vërtetë: pas gjithë atyre që i kishin ndodhur Danielit ai duhej që t'i shërbente mbretit që i bëri gjithë këto gjëra atij dhe vendit të tij!

Tani, ka gjasa që do ishit shumë të frikësuar nëse do t'ju detyronin të ishit në një situatë të tillë. Gjëja madhështore është që edhe pse Danieli ishte në një vend të huaj, ai nuk ishte vetëm. Perëndia u siguroi që Danieli të kishte shokë që do ta ndihmonin të ndiqte Perëndinë dhe të kujtonte sesi Perëndia i kishte trajnuar në Izrael.

Tema e kësaj jave është triumfo, dhe do të flasim shumë sesi Danieli fitoi mbi vështirësitë në jetën e tij. A e mban mend ndonjëri prej jush se çfarë do të thotë të triumfosh? Shkëlqyeshëm! Të triumfosh do të thotë të kesh sukses kur gjërat janë të vështira. Sikurse do ta shohim në jetën e Danielit këtë javë, ai triumfoi mbi shumë gjëra të vështira. Ne mund të mësojmë nga shembulli i tij për të fituar mbi gjërat e vështira në jetën tonë. Tema e sotme është – për të fituar duhet të jemi të mësueshëm. Kur dëgjojmë Perëndinë që na krijoi mund të triumfojmë! Perëndia na krijoi të ishim në ekipin e Tij, të kishim një marrëdhënie me Të! Ai gjithashtu krijoi njerëz të tjerë të mrekullueshëm për të qenë në ekipin e Tij bashkë me ne.

Le të lexojmë rreth Danielit nga Danili 1:8. Nëse një histori është në Bibël, a është histori e vërtetë apo e shpikur? Saktë, është histori e vërtetë. Ne mund të besojmë që Bibla është e vërtetë sepse ajo është fjala e Perëndisë për ne dhe Perëndia thotë gjithmonë të vërtetën.

Lexoni Danieli 1:8

Pse ishte aq e rëndësishme që Danieli të mos hante ushqimin e mbretit? Ai donte të tregonte që ishte në ekipin e Perëndisë. Për Danielin do kishte qenë shumë e lehtë të përshtatej dhe të harronte gjithçka që kishte mësuar për Perëndinë. Perëndia e kishte trajnuar Danielin që kur ishte i vogël. Perëndia nuk e la kurrë në baltë dhe i kishte dhënë gjithçka që kishte nevojë! Cilat janë disa gjëra në të cilat Perëndia mund t'ju trajnojë edhe ju?

Ato janë përgjigje shumë të mira. Personi që ishte përgjegjës për Danielin ishte i shqetësuar për shkak të planit të tij të ri. Le të shohim pse:

Lexoni Danieli 1:9-10

Kjo ka kuptim – nuk do ishte gjë e mirë që Danieli dhe miqtë e tij t'i hapnin probleme mbikëqyrësit të tyre! A mendoni se ai kishte të drejtë? Me gjithë sa di unë rreth ushqimit, kjo ka kuptim. Për shumë njerëz, nëse hanë vetëm perime dhe pijnë ujë mund të mos rriten aq shumë sa dikush që ha ushqimin më të mirë dhe pi pijet më të mira. Përveç kësaj, ata mund të jenë shpesh të uritur. Le t'i kthehemi historisë dhe të dëgjojmë planin e Danielit të cilin ai e kishte mësuar nga Perëndia.

Lexoni Danieli 1:12-14

Kjo duket mjaft e drejtë. Çfarë mendoni se ndodhi? A e fituan këtë përlëshje Danieli dhe shokët e tij që ishim mësuar prej Perëndisë?

Lexoni Danieli 1:15-16

Kjo është vërtet e mahnitshme! Edhe pse ata hëngrën vetëm perime, ata ishin më të mëdhenj dhe më të fortë se gjithë të tjerët. Jo vetëm kaq, por Perëndia i dha Danielit dhe shokëve të tij urtësi që të ishin më të mirë. Kur Perëndia ju jep një detyrë Ai do t'ju trajnojë që t'i mposhtni pengesat e vështira dhe do t'ju japë shokë ekipi që do t'ju ndihmojnë. Është interesante të mendojmë që Perëndia ju krijoi të ishit në ekipin e Tij dhe dëshiron t'ju trajnojë!

Lexoni Danieli 1:17-20

Kjo është shumë fantastike! Danieli dhe shokët e tij ka gjasa që ishin të ngazëlluar po diplomoheshin dhe përfunduan shkollën. Mendoj që edhe ju mezi prisni të diplomoheni nga shkolla! Por, doli që Danieli dhe shokët e tij do të përballeshin me shumë vështirësi të mëdha.

Lexoni Danieli 2:1-6

Oh! Mbreti Nebukadensar kërkoi një gjë të pamundur: ai donte që këshilltarët e tij të mençur t'i tregonin ëndrrën që ai kishte parë dhe gjithashtu kuptimin e saj. Kjo është çmenduri! A mund të tregoni se çfarë ëndrre kanë parë shokët tuaj nëse ata nuk ju tregojnë? Është e pamundur të hamendësosh çfarë ëndërre ka parë dikush nëse nuk ua tregojnë vetë, këtë gjë e dinin mirë edhe këshilltarët e mençur. Ata nuk mund ta tregonin dot ëndrrën dhe mbreti u zemërua: ai urdhëroi që të vriteshin të gjithë këshilltarët e tij. Këtu përfshihej edhe Danieli me shokët e tij!

Danieli dëgjoi për këtë gjë dhe kërkoi të takohej me mbretin dhe i premtoi që do t'i tregonte ëndrrën. Pas kësaj ai shkoi tek shokët e tij dhe iu dha lajmin: nëse trajneri i tyre nuk i ndihmonte duke iu dhënë një rrugëdalje ata do të vriteshin. Ata gjithashtu kishin nevojë të dëgjonin trajnerin dhe të ishin të mësueshëm në mënyrë që të kuptonin ëndrrën e Nebukadnesarit. Kjo na sjell tek ideja jonë kryesore: Perëndia është trajneri më i mirë për ekipin tuaj.

Këtu ka rëndësi të qenët në ekipin e Perëndisë. Përballë një situatë të pamundur, shokët e Danielit u lutën për të. Për të fituar duhet të jemi në ekipin e Perëndisë... dhe duhet të zgjedhim të jemi të mësueshëm prej Perëndisë. Nëse përpiqemi t'i kalojmë pengesat me forcën tonë, nuk kemi për të patur sukses! Perëndia na krijoi të jemi pjesë e një ekipi, dhe na takon ne që të zgjedhim të jemi të mësueshëm prej Tij edhe kur gjërat janë të vështira. Është shumë gjë e mirë që Danieli kishte një ekip të tërë tek i cili mund të mbështetej, apo jo? Është edhe më e mahnitshme që ata kishin një trajner shumë të mirë, Perëndinë, i cili kujdesej personalisht për ta.

A mund ta imagjinoni sa të shqetësuar duhet të kenë qenë Danieli dhe shokët e tij? Ishte sikur ata po luanin lojën më të rëndësishme të jetës së tyre, vetëm se po të humbisnin, do të vdisnin! Le të shohim sërish Biblën dhe të mësojmë se çfarë ndodhi:

Lexoni Danieli 2:19

Uau, Perëndia është me të vërtetë trajneri më i mirë! Perëndia i dha Danielit përgjigjen! Çfarë tha Danieli për këtë gjë?

Lexoni Danieli 2:20-23

Danieli e dinte që të ishte pjesë e ekipit të Perëndisë do të thoshte t'ia kushtojë gjithë suksesin Perëndisë. Danieli nuk mund të thoshte që kishte sukses nga vetja e tij sepse ai kishte një trajner shumë të mirë dhe një ekip të mrekullueshëm. Shokët e ekipit të tij u lutën dhe Perëndia siguroi përgjigjen. Ja sesi Danieli ia dha gjithë meritën Perëndisë kur foli me Mbretin Nebukadnesar:

Çfarë gjëje madhështore për t'u thënë! Është gjithmonë shumë mirë t'ia japim Perëndisë meritën për suksesin. Ne jemi në ekipin e Tij, dhe kur tregohemi të mësueshëm, Ai është personi që na ndihmon të fitojmë. Cilat janë disa mënyra sesi mund t'ia jepni meritën Perëndisë kur ju ndodhin gjëra të mira apo kur keni sukses?

Ato janë disa gjëra shumë të mira për t'u bërë. Ëndrra e Nebukadnesarit ishte interesante: ai pa një statujë të madhe prej metalesh të ndryshme që dukej shumë e fortë, derisa një gur erdhi dhe e goditi statujën. Guri u bë mal dhe vazhdoi përgjithmonë. Perëndia dëshironte të bëhej trajneri i Nebukadnesarit dhe po i fliste atij përmes një ëndrre. Ajo që Perëndia po i thoshte Nebukadnesarit përmes ëndrrës është që mbretëritë njerëzore do të vijnë dhe do shkojnë. Nuk ka rëndësi sa e fortë do jetë çdo mbretëri, ajo nuk do të mbetet përjetë.

Me këtë ëndërr, Perëndia po premtojte shpresë për këdo që është në ekipin e Tij. Perëndia dëshiron një marrëdhënie me krijesën e Tij! Ai është trajneri përfundimtar dhe dëshiron që secili nga anëtarët në ekipin e Tij të jetë i mësueshëm! Perëndia e krijoi secilin të ishte pjesë e ekipit të Tij përgjithmonë! Sa fantastike është kjo? Perëndia i gjithësisë kujdeset për ju aq shumë sa dëshiron të jetë trajneri juaj! Trajneri që kishte Danieli dëshiron të jetë trajneri juaj dhe t'ju ketë në ekipin e Tij përgjithmonë! Nesër do të flasim më tepër sesi njeriu i parë nuk ishte i mësueshëm dhe nuk e ndoqi planin e Perëndisë, dhe kjo do të thoshte që s'mund të ishte më në ekipin e Perëndisë. Perëndia ende kishte një plan që ne të ishim përgjithmonë në ekipin e Tij, a nuk është kjo e mrekullueshme? Një ditë, Perëndia do të kthehet si trajner dhe do të sigurohet që të kujdeset përgjithmonë për ekipin e Tij.

Pasi Danieli e shpjegoi ëndrrën për Mbretin Nebukadnesar, ja se çfarë tha Mbreti:

Lexoni Danieli 2:47

Si një lojtar i mirë i ekipit, Danieli i kujtoi shokët e ekipit të tij të cilët e mbështetën. Ai kërkoi pozita të mira për Shadrakun, Meshakun dhe Abednegonë. Sa e mrekullueshme që është kjo? Danieli u siguroi që ta ndihmonte ekipin e Perëndisë. Ata të gjithë e dëgjuan Perëndinë dhe dëshironin të kishin një marrëdhënie me Të. A jemi edhe ne të gatshëm ta dëgjojmë Perëndinë? Edhe kur diçka nuk ka kuptim, a jemi të gatshëm të mësohemi prej Perëndisë? E mbani mend idenë tonë kryesore? Perëndia është trajneri më i mirë për ju dhe ekipin tuaj!

DITA DY

Pasqyra e Ditës

TEMA: Ji i guximshëm

HISTORIA BIBLIKE: Furra e Zjarrtë (Danieli 3)

PIKA KYÇE: Perëndia na jep guxim të qëndrojmë për atë që është e drejtë

HISTORIA E PERËNDISË: Jezusi bën gjithmonë gjënë e duhur

Lista e Këngëve

1. I Believe in Jesus
2. Brave
3. High Power
4. Movin' Me
5. 10,000 Reasons
6. Shine

NXEMJA

Mirë se erdhët sërish në kampin Triumfo! A u kënaqët dje? Kush mund të më tregojë një gjë që keni mësuar dje?

Fantastike! Këtë javë kemi disa trajnerë shumë të mirë në kamp të cilët do vazhdojnë t'ju ndihmojnë të mësoni! A mund të më thotë dikush se cila është tema jonë për këtë javë? Saktë! Tema është TRIUMFO! Tani, kush mund të më thotë se çfarë kuptimi ka kjo?

Mirë! Do të thotë të kesh sukses kur përballesh me problem dhe vështirësi. A kishte gjëra të vështira për t'u kaluar dje? Dje folëm për vargun e javës, le ta rishikojmë shpejt e shpejt. Çohemi të gjithë në këmbë dhe ta praktikojmë së bashku!

(Shihni pjesën për vargun dhe lëvizjet)

Shumë mirë, që të gjithë! Do vazhdojmë të punojmë me këtë gjë. Kur ta keni mësuar përmendësh, mund t'ia thoni njerit prej trajnerëve që kemi këtu në kamp!

Dje mësuaam që për të triumfuar duhet të jemi të? Mësueshëm! Kush është trajneri ynë më i mirë? Perëndia është trajneri ynë më i mirë! Ai e krijoi secilin prej nesh që të ishim në ekipin e Tij. Ne duhet të zgjedhim ta lejojmë Perëndinë të na mësojë.

Gjëja më e madhe që Perëndia mund të na ndihmojë ta mposhtim është diçka e quajtur mëkat. Mëkati është gjithçka mendojmë, themi apo bëjmë që e trishton Perëndinë. Për ta mposhtur mëkatin duhet të jemi të gatshëm të bëjmë atë që është e drejtë pavarësisht se sa e vështirë mund të jetë. Ne duhet të jemi të guximshëm! Kjo në fakt është tema jonë për sot! Për të triumfuar kemi nevojë të jemi të guximshëm. Dje mësuaam të jemi të mësueshëm dhe sot do të mësojmë të jemi të guximshëm.

Çfarë do të thotë të jemi të guximshëm?

Saktë! Të jesh i guximshëm nuk do të thotë që nuk kemi asnjëherë frikë, por do të thotë që edhe kur kemi frikë mund të zgjedhim të bëjmë atë që është e drejtë. Këtë gjë nuk mund ta bëjmë dot vetë! Duhet të mbështetemi tek Perëndia – trajneri ynë i madh – në mënyrë që të jemi të guximshëm dhe të fitojmë.

Luajtja e sporteve të ndryshme mund të na ndihmojë të mësojmë të jemi të guximshëm. Qoftë kur përballemi me kundërshtarë më të fortë apo kur përpiqemi të mësojmë një aftësi të re. Guximi në sport do të thotë që edhe kur diçka është e frikshme ende do të përpiqemi fort dhe të presim rezultatin. Kur flasim për Perëndinë e dimë

që Ai na jep guxim për të bërë gjënë e drejtë! Nuk ka rëndësi cila është situata. Puna jonë është të bëjmë atë që Perëndia na kërkon dhe ta lejojmë Atë të vendosë se cili do jetë rezultati.

Prandaj sot kur të provoni një aftësi të re në sportin tuaj, apo të flisni me një kampist të ri në ekipin tuaj, mund të jeni të guximshëm dhe të bëni më të mirën!! Pastaj ndërsa do dëgjojmë historitë mund të mendojmë sesi mund të jemi të guximshëm edhe në momentet më të frikshme të jetës tonë.

HISTORIA E SPORTIT

Elana Taylor

Sot tema jonë është, që të triumfojmë duhet të jemi çfarë?

Të guximshëm! Për të fituar, duhet të jemi të guximshëm. Kush e mban mend se çfarë do të thotë të jesh i guximshëm?

Saktë! Do të thotë të jesh në gjendje të bësh diçka që të frikëson. Cilat janë disa nga gjërat që ju frikësojnë? A zgjidhni ndonjëherë që të mos bëni diçka sepse keni frikë? Të jesh i guximshëm do të thotë që edhe kur jemi të frikësuar vazhdojmë të bëjmë atë që është e drejtë.

Sot, dëshiroj t'ju tregoj për një sport që më duket shumë i frikshëm dhe ka të ngjarë që nuk do ta bëjë. Rrëshqitja me stlitë të shpejtë!

A mund të më thotë dikush çfarë lloj sporti është ky?

Rrëshqitja me stlitë të shpejtë është një sport ku ekipet hipin në një stlitë në majë të një piste të gjatë. Kjo pistë është prej akulli. A është akulli gjë e butë?

Jo! Akulli është i fortë. Nëse rrëzohesh në akull lëndohesh. Sportistët e këtij sporti rrëshqasin përgjatë pistës së akullit me shpejtësi deri 155 kilometra në orë. Kjo është shumë shpejt! Me atë shpejtësi nëse bëni edhe gabimin më të vogël në manovrimin e stlitës mund të përplaseni anash pistës dhe kjo mund të ketë pasoja serioze.

Elana Meyers Taylor ishte një sportiste e talentuar nga SHBA e cila tregonte guxim çdo herë që rrëshqiste përgjatë pistës. Si pilote, Elana ishte përgjegjëse për të manovruar përgjatë pistës në mënyrë sa më të sigurt dhe sa më të shpejtë. Në historinë e sotme Elana tregoi guxim dhe shkathtësi të jashtëzakonshme në disa situata shumë të frikshme.

Në Alternburg të Gjermanisë kishin një pistë akulli. Elana pa një garë në këtë pistë ku dy sportistë u përplasën aq keq sa që u desh t'i çonin me urgjencë në spital. Vitin tjetër, Elana dhe ekipi i saj duhej të garonin në këtë pistë. A mendoni se ajo ishte e frikësuar?

As që mund ta imagjinoj dot të qëndroja në fillim të kësaj piste akulli për të garuar duke e ditur që aty njerëzit ishin bërë për në spital. Elana bëri saktësisht këtë. Elana dhe anëtarët e ekipit të saj e mposhtën frikën dhe u futën në stlitën e tyre për rrëshqitjen e parë përgjatë kësaj piste.

Elana kujton dhe thotë, "Hera e parë ishte shumë tronditëse. Ndjeva sikur e humba krejtësisht kontrollin e stlitës; po përplasesha ngado me muret, pastaj rrëshkisja dhe pastaj përplasesha sërish... E kaluam herën e parë, por mendoj se u largova me më shumë pyetje dhe dyshim ndërsa po fërkoja nofullën që më ishte vrarë." Elana kishte goditur kokën dhe nuk ishte e sigurt sesi do vazhdonte më tej.

Ditën tjetër pati një provë tjetër. Ndërsa po fillonte rrëshqitjen ishte edhe më e nervozuar. Kur po i afrohej kthesës numër 9 (e njëjta kthesë ku kishte vrarë kokën ditën e kaluar) iu kujtua që kuptoi sa larg ishin. Ndërsa dolën nga kthesa ishin kthyer me kokëposhtë!! Jo thjesht që po përmbyseshin por ishin kthyer krejt kokëposhtë por po i afroheshin një kthese të fortë. Ishte një përplasje aq e dhunshme sa që një nga sportistët doli nga slita. Elanës i kujtohet që pothuaj sa nuk po villte nga gjithë lëvizjet dhe goditjet që pësuan trupat e tyre kur u përplasën.

Duket si arsye e mirë që nëse përplasesh të mos vish dhe ta provosh sërish, por tërheqja nuk do ishte gjëja e duhur për t'u bërë. Shoqet e saj të ekipit prisnin që ajo të mësonte nga gabimet dhe të mos dorëzohej. Elana e dinte që duhej të tregojë e guximshme në mënyrë që ta mposhte frikën e saj dhe të bënte gjënë e duhur për shoqet e ekipit. Pas disa ditësh kishin edhe dy prova të fundit. Ndërsa shkuan në majë të pistës dhe hodhën vështrimin poshtë nuk mund ta imagjinoj sesi u ndjenë kur menduan që mund të pësonin një përplasje tjetër

edhe më të keqe. Elana e pranon që nuk i kujtohen shumë gjëra rreth garës por i kujtohet kur sheh kohën në fund dhe kur sheh numrin gjigant 1 përkrah kohës së tyre. Kjo do të thoshte që jo vetëm kishin mbijetuar por edhe që kishin fituar! Ato ishin ekipi më i shpejtë! A do kishte ndodhur kjo gjë nëse ato do ishin tepër të frikësuar dhe të mos e mposhtnin frikën e tyre me guxim?

Elana ia jep lavdinë Perëndisë dhe e falënderon Atë për mbrojtjen që Ai i siguroi. Në të njëjtën mënyrë do të shohim më vonë sesi disa nga shokët e Danielit e mposhtën frikën duke u fokusuar tek Perëndia. Kur fokusohemi tek Perëndia mund të gjejmë guximin për të bërë gjënë e duhur! Ky fokusim tek Perëndia na jep guxim, i cili mund të mposhtë frikërat tona. Nuk do të thotë që frikërat tona largohen – pista e akullit nuk u bë më e lehtë për Elanën. Përkundrazi, Elana u fokusua tek Perëndia dhe gjeti guximin që i nevojitej për të vazhduar që të bënte gjënë e duhur. Qoftë një provim në shkollë, përballja me dikë që bën të fortin, ndarja e besimit tonë apo kur kalojmë një të papritur, fokusimi tek Perëndia na ndihmon të jemi të guximshëm dhe ta mposhtim frikën.

SHEMBULL MËSIMI

Përgatitja: një formacion konesh për të ecur nga një anë në tjetrën. Jepuni trajnerëve topat e futbollit apo objektet e “buta” ndërsa ata qëndrojnë përgjatë koneve nga jashtë shtegut. Udhëzohuni trajnerët t’ju hedhin juve topat kur të bëni demonstrimin (por të mos i hedhin drejt kokës). Pastaj kur kampioni të kalojë përgjatë shtegut trajnerët nuk do t’i hedhin topat ose do t’i hedhin ata qëllimisht që të mos e prekin kampionin.

Sa gjë e frikshme ishte ajo që përjetoi Elana! Imagjinoni sikur të ishit ju duke rrëshqitur në një pistë akulli dhe koka t’ju përplasej gjithandje! Sot do të flasim rreth guximit dhe se çfarë kërkohet për të qenë i guximshëm. A do të thotë që kur jemi guximtarë nuk kemi frikë? Të jemi të guximshëm do të thotë që bëjmë atë që duhet edhe kur jemi të frikësuar.

Sot kemi një shpërblim të veçantë, po në mënyrë që ta fitoni dikush duhet të tregohet i guximshëm. Më lejoni ta demonstroj unë dhe pastaj do të kërkoj një vullnetar prej jush. Dua ta dini se çfarë do ndodhë para se të dilni vullnetar. Këtu kemi disa trajnerë dhe secili prej tyre ka dy topa. Afër këtyre koneve kemi një shpërblim të veçantë. Në mënyrë që të kaloni nga kjo anë tek tjetra duhet të kalojë përmes topave që hedhin trajnerët. Trajnerët janë shumë të fortë dhe mund ta hedhin topin me shumë forcë, prandaj a nuk mendoni që do jetë paksa e frikshme që të kaloni nga kjo anë tek tjetra për të marrë shpërblimin e veçantë?

Unë për vete kam pak frikë. Jam më i madh se shumica prej jush prandaj nuk mendoj që do më lëndojnë aq shumë sa do t’ju lëndonte ju. Ta provojmë? Mirë, do kem nevojë për pak ndihmë që të marr guxim. A mund të brohorisni për mua? Faleminderit shumë! Mirë, fillojmë... **Filloni të ecni me sytë e mbyllur. Kur ju godet një top bëni sikur iu lëndoi shumë. Aty nga mesi i shtegut dorëzohuni dhe kthehuni pas.**

Nuk munda të dal dot në anën tjetër sepse trajneri _____ atje duket shumë i madh dhe kisha frikë që do më dhimbte shumë po të më gjuante me top prandaj u ktheva pas. Kam nevojë për dikë që ka më tepër guxim se unë. **Zgjidhni një fëmijë më të vogël por që duket i sigurt.**

A je i sigurt që do ta bësh këtë? Nëse do të qëllojë trajneri _____ mendon se do të të dhëmbë? A ke frikë? Nuk je fare i shqetësuar? Mirë, të siguroj që po të vraposh sa më shpejt të kesh mundësi mund të mos të prekë asnjë top... ndoshta do të prekë... mund të të lëndojë... mendon se ke mjaft guxim sa për ta provuar? A mund ta mposhtë frikën dhe shqetësimin duke u treguar i guximshëm? Fokusohu në atë që ke nevojë të bësh, mos u fokuso tek trajnerët e mëdhenj dhe të frikshëm. Gati je? Mirë, mendoj që _____ ka nevojë për pak inkurajim. A mund ta inkurajoni?

Përsosur! Gati, nisu...

URRA! E more shpërblimin e veçantë! Fantastike! Duhet t’i kishte parë fytyrat e trajnerëve ndërsa po vrapoje gjatë shtegut. Guximi yt ishte i jashtëzakonshëm dhe u duk në mënyrë të qartë sepse e mposhte frikën.

Gjatë ditës së sotme do të shohim sesi shokët e Danielit ishin në një situatë ku duhet të jenë frikësuar, por gjithsesi bënë gjënë e duhur pavarësisht vështirësive! Ata u fokusuan tek ajo që ishte e rëndësishme dhe jo tek gjërat e frikshme përreth tyre. Nganjëherë nuk e kemi guximin për të bërë gjënë e duhur dhe kështu zgjedhim të bëjmë diçka që shkon kundër asaj që do Perëndia. Ky quhet mëkat dhe e lëndon marrëdhënien tonë me Perëndinë. Perëndia nuk dëshironte që marrëdhënia jonë me të të mbetej e prishur. Jezusi erdhi për të na falur mëkatet duke jetuar një jetë të përsosur këtu në tokë, duke mos mëkatuar kurrë, duke sakrifikuar veten e tij

në kryq dhe duke u ringjallur prej së vdekuri! Duhet të fokusohemi tek të qenurit guximtarë kur tundohemi të mëkatojmë. Fokusohuni tek më e mira dhe jo tek ajo që ju frikëson për momentin.

HISTORIA BIBLIKE

Furra e Zjarhtë (Danieli 3)

Para se të shkojmë tek historia e sotme le të kalojmë disa momente për të rishikuar atë që mësuam dje. Cila ishte tema për ditën e djeshme? Për të triumfuar duhet të jemi të mësueshëm. Kush është trajneri ynë më i mirë? Perëndia! Për kë fliste historia jonë dje? Për Danielin dhe shokët e tij. A i mban mend dikush emrat e shokëve të Danielit? Mirë! Janë paksa të vështirë: Shadrak, Meshak dhe Abednego. Ata zgjodhën të ishin në ekipin e Perëndisë edhe kur ishte e vështirë dhe Perëndia i ndihmoi të fitonin mbi pengesat e shumta ku përfshihen largimi nga shtëpitë e tyre, detyrimi për të ngrënë ushqime të çuditshme dhe pengesa e tyre më e madhe: t'i tregonin një mbreti të fuqishëm ëndrrën e tij dhe çfarë kuptimi kishte ajo. Kush i ndihmoi si trajneri i tyre përgjatë gjithë këtyre pengesave? E saktë, Perëndia ishte ai që i ndihmoi!

Historia e sotme ka të bëjë më tepër me Shadrakun, Meshakun dhe Abednegonë. Le t'i themi së bashku emrat e shokëve të Danielit sepse është goxha argëtim, SHA-dra-ku, ME-sha-ku dhe A-bed-ne-go.

Këta djem ishin shumë të rëndësishëm. Nëse ju kujtohet, Perëndia iu kishte dhënë gjithçka u duhej për të fituar dhe për të patur sukses në punët e tyre dhe të ishin më të mirët që kishin mundësi të ishin. Mos do të thoshte kjo që gjërat me të cilat u përballën ishin të lehta? Aspak! Ishte shumë e vështirë dhe nganjëherë e frikshme. Në mënyrë që të bënin gjënë e duhur duhej të kishin guxim. A mund të më kujtojë dikush se çfarë do të thotë guxim? Do të thotë të bësh gjënë e duhur edhe kur je i frikësuar. Kjo do të thotë edhe kur Shadraku, Meshaku dhe Abednegoja ishin të frikësuar ata ende bënë gjënë e duhur.

Kush e mban mend emrin e mbretit të Babilonisë? Nebukadnesari, e saktë. A nuk është ky emri më qesharak? Nuk do donit që këtë gjë t'ia thoshit vetë mbretit. Nebukadnesari ishte një mbret shumë i pushtetshëm që sundonte mbretërinë më të madhe të asaj kohe. Një ditë Nebukadnesari vendosi të ndërtonte një statujë të bërë prej ari e cila ishte 30 metra e lartë. Kjo është gjigante! Është pothuaj sa një e treta e gjatësisë së një fushe futbollli! Nebukadnesari kishte disa udhëzime shumë specifike në lidhje me këtë statujë të cilat i përhapin përmes lajmëtarëve të tij. Mbani mend që në atë kohë nuk kishin internet. Ata kishin disa mënyra të ndryshme për të përhapur lajmin. Le të dëgjojmë atë që kishin për të thënë lajmëtarët:

Lexoni Danieli 3:4-6

Uau! Shumë udhëzime. Kur njerëzit të dëgjonin këto instrumenta të çuditshme që fillonin të binin njëherësh ata duhej të përuleshin dhe ta adhuronin statujën. Nëse nuk do ta bënin do të hidheshin në furrën e zjarhtë. E frikshme!

Kush mund të më thotë se çfarë nuk shkon me atë që Nebukadnesari u kërkoi që të bënin njerëzit? E saktë: njerëzit nuk duhet të adhurojnë një statujë. Njerëzit duhet të adhurojnë vetëm Perëndinë. Dje folëm sesi Perëndia na krijoi që të ishim në ekipin e Tij. A duket sikur të gjithë njerëzit që u përulën para statujës ishin në ekipin e Perëndisë? Çfarë do të thotë të adhurosh Perëndinë? Çfarëdo gjëje tjetër është mëkat. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi apo bëjmë e cila nuk e kënaq Perëndinë. Të gjithë këta njerëz po mëkatonin duke adhuruar një perëndi të rremë, një statujë.

Kjo nuk është gjë e mirë. Të gjithë ata zgjodhën të mos ndiqnin Perëndinë, me përjashtim të tre personave. Kush mendoni se ishin këta të tre?

Ishin disa persona të quajtur Kaldeas të cilët vendosën të flisnin kundër Shadrakut, Meshakut dhe Abednegosë. Këta të tre ishin në ekipin e Perëndisë dhe kishin shumë guxim. Ata vendosën ta mundnin mëkatin duke zgjedhur të ndiqnin dhe të adhuronin Perëndinë në vend të idhullit që kishte ngritur Nebukadnesari. Mbani mend se çfarë do ndodhte nëse dikush nuk do ta adhuronte statujën? Do të hidheshin në furrën e zjarhtë!

A ju është dashur ndonjëherë që të bëni një zgjedhje për të bërë diçka që e dinit se ishte e drejtë duke e ditur që do kishit pasoja negative? Nganjëherë kur përballemi me vendime të tilla vendosim të mos bëjmë gjënë e duhur dhe të mëkatojmë. Kjo e trishton Perëndinë sepse Ai dëshiron që ne ta mundim mëkatin duke e ndjekur Atë dhe duke qenë në ekipin e Tij. Ne e dimë që Perëndia na jep guxim për ta bërë këtë gjë sepse Ai na do dhe dëshiron të jemi në ekipin e Tij.

Ja se çfarë ndodhi më pas:

Lexoni Danieli 3:13-15

Nebukadnesari nuk ishte i lumtur. Ai u dha një mundësi të dytë që t'i bashkoheshin turmës dhe të mëkatonin. Ai e bëri shumë të lehtë për ta dhe mendoj që secili prej nesh do ta kishte konsideruar. Të shkosh në furrën e zjarrtë apo thjesht të bësh një përkulje të shpejtë?

Ne shpesh tundohemi të mëkatojmë por duhet që ta mposhtim mëkatin. Problemi është që nuk mundemi – të paktën jo çdo herë. Nganjëherë mund t'ia dalim por shumë herë mëkatojmë. Askush nuk është i përsosur. Kur mëkatojmë marrëdhënia jonë me Perëndinë dëmtohet. Marrëdhënia është si puna e shoqërisë, apo si mënyra që jemi të lidhur me njëri-tjetrin. Duhet që të na falet mëkati para se të kemi sërish një marrëdhënie me Perëndinë. Perëndia na ka thënë që të mos adhurojmë perëndi të tjerë, apo idhuj. Çfarë do të thotë të adhurojmë një idhull? E saktë. Do të thotë që ta bësh diçka më të rëndësishme se Perëndinë. Cilat janë disa gjëra të cilat njerëzit e sotëm i vendosin para Perëndisë?

Shadraku, Meshaku dhe Abednego kishin një zgjedhje për të bërë: të ishin guximtarë dhe ta mundnin mëkatin duke ndjekur Perëndinë, ose të tregoheshin të pabindur ndaj Perëndisë dhe të mëkatonin duke adhuruar idhullin e ngritur nga mbreti. Kjo është zgjedhje shumë e vështirë. Çfarë do kishit thënë ju? A do kishit qenë aq të guximshëm? Ja se çfarë i thanë mbretit Shadraku, Meshaku dhe Abednego:

Lexoni Danieli 3:16-18

Uau! Kjo ishte vërtet e guximshme! Kërkohet shumë guxim të çohesh dhe të bësh zgjedhjen e duhur si kjo. Kjo në fakt është ideja jonë kyçe për sot: Perëndia na jep guxim të qëndrojmë për atë që është e drejtë. Ne e dimë që gjëja e duhur është të adhurojmë Perëndinë sikurse Shadraku, Meshaku dhe Abednego! Pse mendoni që ata ishin në gjendje që të merrnin atë lloj vendimi? Sepse ishin të bindur që të jesh në ekipin e Perëndisë do të thotë që Perëndia do i ndihmonte të fitonin. Ja gjëja kryesore: ata kuptuan që mund të vdisnin; megjithatë, ata ende besonin që në fund të fundit Perëndia do t'i ndihmonte të fitonin. Uau! Ky është besim i madh në Perëndinë. Nuk ka rëndësi se çfarë ndodh, mund të besojmë që Perëndia është i mirë dhe do të kujdeset për ne. Shadraku, Meshaku dhe Abednego menduan që ishte më mirë të shkonin në furrën e zjarrtë dhe të jetonin përgjithmonë me Perëndinë sesa të mëkatonin dhe ndoshta të jetonin përgjithmonë të ndarë nga Perëndia.

Lexoni Danieli 3:19

A mund ta imagjiloni se sa e frikshme që duhet të ketë qenë për këta tre shokë? A mendoni se u desh shumë guxim nga ana e tyre? Sikur të mos mjaftonte fakti që i hodhën në furrën e zjarrtë, Nebukadnesari urdhëroi që furra të nxehej shtatë herë më fort se normalisht thjesht për t'u siguruar që do të 'piqeshin mirë'!

Nebukadnesari urdhëroi disa prej ushtarëve më të fortë që t'i lidhnin Shadrakun, Meshakun dhe Abednegonë dhe pastaj t'i hidhnin në furrë. Për shkak se ishte shumë e nxehtë ushtarët e fuqishëm vdiqën sepse u afruan shumë. Ka të ngjarë që Nebukadnesari po ndihej mirë – tani ua kishte treguar vendin këtyre tre personave që nuk i ishin bindur urdhërit të tij.

Pastaj ndodhi e papritura, guximi i tyre dhe vendosmëria për të bërë gjënë e duhur filluan të tregonin se sa i madh është Perëndia!

Lexoni Danieli 3:24-25

Ata jo vetëm që ishin gjallë, por ishin duke ecur brenda furrës së zjarrtë. Litarët që i lidhnin ishin djegur por ata nuk ishin lënduar. Sa e mahnitshme është kjo! A mendoni se shumë nga njerëzit që po shihnin tani e dini sa i madh ishte Perëndia? Mos harroni pjesën e fundit! Nebukadnesari pa një person të katërt në furrë! Perëndia tregoi sa i gatshëm ishte që t'i ndihmonte këta tre djem kur ata treguan aq shumë guxim për Të!

Kjo na sjell tek një pikë e rëndësishme: ne mund të kemi guximin për ta mundur mëkatin për shkak se e dimë që Perëndia është me ne pavarësisht se çfarë ndodh.

Lexoni Danieli 3:26-27

Ata të tre jo vetëm që mbijetuan por as që binin erë tym. Sa e mrekullueshme!

Nebukadnesari e dalloi fuqinë e Perëndisë. Kur e mposhtim mëkatin duke ndjekur Perëndinë njerëzit e dallojnë këtë gjë. Prandaj, si mund të jemi të guximshëm? Cilat janë disa gjëra që mund t'i bëni të cilat do t'ju ndihmojnë të jeni të guximshëm?

E dimë që kërkohet guxim për ta mundur mëkatin dhe për të bërë atë që është e drejtë. Ku mund ta gjejmë guximin për ta bërë këtë gjë? Nga Perëndia. E vërtetë! Cilat janë disa gjëra të këqija që mund t'ju kërkojnë t'i bëni ose që mund t'ju duken edhe si ide e mirë?

Këta janë shembuj shumë të mirë! A do jemi ndonjëherë të përsosur? JO! Perëndia e di këtë. Perëndia kishte një plan që edhe kur nuk jemi të përsosur ende mund të jemi me Të përgjithmonë! Ende mund të kemi guxim sepse Perëndia vazhdon të kujdeset për ne! Edhe pse nuk bëjmë gjithmonë gjënë e duhur Jezusi është ai që gjithmonë bëri gjënë e duhur! Ai jetoi një jetë të përsosur. E vetmja mënyrë sesi mund të mundej mëkati ynë ishte përmes dikujt që nuk mëkatoi kurrë dhe zgjodhi të jepte jetën e Tij dhe të mundte vdekjen në mënyrë që ne të ishim me Perëndinë përgjithmonë! Sa e mrekullueshme është kjo?!

Ajo që ne kemi nevojë të bëjmë është të besojmë që Jezusi është e vetmja mënyrë sesi ne mund të jemi përgjithmonë me Perëndinë! Kaq. Ne të gjithë kemi mëkatuar, por mëkatet tona mund të falen, besimi në Jezusin është e vetmja mënyrë sesi mëkatet tona mund të falen. Sapo të kemi sërish një marrëdhënie me Perëndinë Ai mund të na ndihmojë të jemi të guximshëm dhe ta mundim mëkatin në jetën tonë!

DITA TRE

Pasqyra e Ditës

TEMA: Ji i përlur

HISTORIA BIBLIKE: Poshtërimi i Nebukadnesarit (Danieli 4)

PIKA KYÇE: Perëndia na kërkon të jemi të përlur dhe të ecim me Të

HISTORIA E PERËNDISË: Perëndia ju fal kur nuk bëni gjënë e duhur

Lista e Këngëve

1. Inside My Heart
2. Shine
3. Nothing Better
4. Movin' Me
5. 10,000 Reasons
6. Brave

NXEMJA

Përsëritet! Jemi shumë të ngazëlluar që keni ardhur sot në kampin e sporteve! Këtë javë po mësojmë sesi të triumfojmë.

Ditën e parë mësuam që për të triumfuar duhet të jemi të mësueshëm! Mësuam gjithashtu që Perëndia është trajneri ynë më i mirë. Ai e krijoi secilin nga ne që të jemi në ekipin e Tij.

Dje mësuam që për të triumfuar duhet të jemi të guximshëm! Çfarë do të thotë kjo?

Po, të jesh i guximshëm do të thotë të bësh atë që duhet bërë edhe kur je i frikësuar. Kemi mësuar nga trajnerët tanë sesi Shadraku, Meshaku dhe Abednego ishin të guximshëm kur të gjithë u thanë që të përuleshin para dikujt tjetër përveç Perëndisë. Besimi i tyre në Perëndinë i bëri që të mos mëkatonin!

Tema për sot është të jemi të përlur. Kush e di çfarë do të thotë të jesh i përlur?

Të jesh i përlur do të thotë të mos mendosh se je më i rëndësishëm se të tjerët. Shumë herë përdorim fjalën krenari për të thënë të kundërtën e përlësisë.

Më lejoni të shpjegoj diçka: nuk ka asgjë të keqe me përpjekjen për të qenë më i miri. Në fakt, secili prej nesh duhet të përpqet të jetë më i miri që ka mundësi të jetë pavarësisht se çfarë bëjmë. Nëse po zgjidhim një problem në matematikë, po mësojmë një varg nga Bibla apo po praktikojmë të luajmë futboll dëshirojmë që të përpqemi sa më fort!

Të jesh i lumtur apo i sigurt për atë që e bëjmë mirë nuk është gjë e keqe. Unë kënaqem me (diçka që e bëni mirë), dhe jam shumë i aftë në këtë gjë. A më bën kjo gjë të jem krenar? Jo, kjo më bën të kem siguri.

Problemi ndodh kur mendojmë se jemi më të rëndësishëm se të tjerët për shkak se jemi më të mirë në diçka se ata. Është sikur t'i thuash vetes, "Jam lojtar shumë i mirë, shokët duhet të ma pasojnë gjithmonë mua topin, dhe unë nuk ka pse t'ia pasoj njeriu tjetër." Kjo ndodh gjithashtu kur mendojmë, "Jam shumë i aftë në këtë gjë saqë nuk ka as pse ta provoj." Kjo është krenari dhe jo përlësi. A e di dikush se çfarë thotë Bibla rreth krenarisë dhe përlësisë?

Tek Jakobi 4:6 thuhet, "Perëndia u kundërvihet mendjemëdhenjve dhe u jep hir të përlurve." A thuhet që nuk duhet të kemi siguri në gjërat që bëjmë? Përlësia është kur e dimë që jemi të mirë në diçka, por nuk mendojmë se jemi më të rëndësishëm thjesht sepse jemi më të mirë në diçka se të tjerët.

Prandaj sot në sesionin e sporteve le të tregojmë përlulësi duke i inkurajuar shokët e skuadrës tonë, të përpigemi të bëjmë më të mirën, dhe t'i dëgjojmë mirë trajnerët tanë! Do ta hapim ditën e kampit me lutje dhe pastaj të shkojmë të luajmë sportet tona!

HISTORIA E SPORTIT

Ekipi i Qytetit të Lesterit

Përsëndetje! Si ishte sesioni i sporteve? A mësuat diçka të re? A bëtë më të mirën që kishit mundësi? A ishit lojtari më i mirë që kishit mundësi të ishit? Mbani mend që sot po flasim rreth përlulësisë.

Historia jonë e sotme e sportit bën fjalë për një ekip futbollit nga Anglia i quajtur Lester. A mund ta themi bashkë? Lester. Ekipi i Lesterit tregoi përlulësi dhe krenari kur luajtën si ekip.

Historia e sotme fillon në vitin 2015. Lesteri ishte një ekip të cilin nuk e vlerësonte askush. Ata nuk ishin një ekip i mirë. Nga 20 ekipe në kategori Lester përfundoi në vend të gjashtëmbëdhjetë.

Prandaj, a mendoni që Lesteri ishte krenar në këtë moment? Ata nuk ishin një ekip i mirë, pothuaj sa nuk ranë nga kategoria dhe nuk pritej që të dilnin më mirë vitin e ardhshëm. Nuk kishin shumë arsye për të qenë krenarë! Në fakt, gjasat që Lesteri të fitonte kampionatin në vitin 2016 ishin 1 në 5,000. Këto nuk janë gjasa shumë të mira.

Por në sezonin e vitit 2016 ndodhi një gjë interesante, Lesteri filloi të fitonte. Ata filluan të fitonin shumë. Në fakt, afër kohës së Krishtlindjes, Lesteri kishte fituar apo dalë barazim mjaft ndeshje për të zënë vendin e dytë.

Jamie Vardy ishte një nga arsyet kryesore që Lesteri po dilte kaq mirë. Ai shënoi gol në 12 ndeshje njëra pas tjetrës. Ky është rekord në futbollin profesional Anglez. I gjithë ekipi luajti bashkë shumë mirë. Në vend që të ishin krenarë për faktin se sa mirë po luanin, ata thjesht vazhduan të fokusoheshin tek ndeshja e radhës. Ekipi nuk kishte yje apo lojtarë të mëdhenj, ishin thjesht një ekip djemsh që luanin bashkë dhe që e vendosën suksesin e ekipit para vetes së tyre. Askush nuk mendonte se ishte më i rëndësishëm se të tjerët në ekip.

Kjo është përlulësi. Ata kishin siguri që ishin të mirë, por nuk mendonin për veten si kampionë. Megjithatë, kjo ndodhi! Lester Siti u bë kampioni i vitit 2016!

Do doja që historia të mbaronte aty dhe që ekipi të vazhdonte të ishte i përlulur. Në 24 vjet asnjë kampion i vitit të kaluar nuk e kishte humbur lojën e parë të sezonit të ri!

Lojën e parë të sezonit të ri Lesteri luajti kundër Hullit. Kur filloi loja mund ta dalloje që Lesteri ishte disi ndryshe nga viti i kaluar. Hulli sapo ishte futur në kategori. Ishte loja e tyre e parë pas një kohe të gjatë dhe ata as që kishin trajner. Trajneri i Hullit ishte pushuar nga puna dhe ende nuk e kishin zëvendësuar, prandaj pritej që Lesteri të fitonte me siguri. Problemi ishte që ata u bënë krenarë. Ata menduan që do ishte e lehtë. Ekipi tjetër madje nuk kishte as trajner! Lesteri mendoi që ishte shumë më i mirë se Hulli. Përveç kësaj ata ishin kampionët prandaj nuk kishte pse të mundoheshin shumë kundër ekipit modest të Hullit!

Më në fund Lesteri e mori topin nga anash dhe kaloi mesfushën.

E gjeni dot se kush ishte atje për të bërë golin e tij të parë të sezonit? Jamie Vardy. Ndërsa topi i erdhi në këmbë ai u përpoq të shënonte edhe pse shoku i tij i ekipit ishte në pozicion më të mirë. Jamie u bë gati të gjuante dhe as që e kapi topin, po kështu ndodhi edhe me shokun e tij të ekipit. Vitin pararendës Jamie do kishte bërë një pasim të thjeshtë tek shoku i tij dhe kishte të ngjarë që do kishin shënuar gol. I gjithë ekipi po sillej sikur ishin lojtari më i mirë në fushë në vend që të luanin me përlulësi si ekip.

Në fund të gjysmës së parë, me shkëlmimin e fundit Hulli shënoi dhe kaloi në avantazh, 1-0. Pas pushimit, Lesteri barazoi por golin nuk e bëri Jamie. Ai humbi dy raste të tjera krejt të pastra.

Komentatori i ndeshjes tha, "Ndoshta tani Lesteri do fillojë të luajë si Lester dhe jo me mendjemadhësinë e kampionëve." Me këtë donte të thoshte që ishte shumë e dukshme që Lesteri mendonte se ishte më i mirë se Hulli dhe nuk po luanin me përlulësi sikurse kishin bërë vitin e kaluar. Më në fund pas një ore lojë u shënuar një gol tjetër? Kësaj here ishte Hulli! Ata shënuan golin e tyre të dytë dhe kështu fituan me rezultatin 2-1. Lesteri kishte vendosur që ishte shumë i mirë sa që nuk kishte pse të fokusohet. Krenaria e tyre i bëri të ishin ekipi i parë në 24 vjet që humbiste lojën e parë pasi kishin fituar kampionatin sezonin pararendës.

Nuk duhet të mendojmë më tepër për veten tonë sesa për ekipin, familjen, miqtë apo këdo tjetër! Më vonë gjatë programit të sotëm do të dëgjojmë për një shembull tjetër të dikujt që veproi me krenari dhe sesi u poshtërua. Por për momentin le të praktikojmë që të jemi më të mirët që kemi mundësi duke mos menduar më tepër se duhet për veten tonë!

SHSEMBULL MËSIMI

Përgatitja: Bëni dy rreshta të drejtë konesh që kampisti t'i përdorë për driblim. Shami për të mbuluar sytë.

Përshendetje kampistë, jam shumë i ngazëlluar për këtë shembull mësimi. Nuk është aq i frikshëm sa ai që bëme ditën e djeshme. Kam nevojë për një vullnetar që mendon se mund të driblojë përgjatë koneve.

Në rregull, këtu kemi (emri i kampistit). Si po ia kalon sot? A mund të më tregosh se për çfarë po flasim sot? Për përlësinë, e saktë. Për të fituar duhet të jemi të përlur. A mund të më thoni se çfarë do të thotë përlësi? Përlësi do të thotë që nuk mendojmë për veten si më të rëndësishëm se të tjerët! Shumë e veçantë, apo jo? Mos do të thotë që po të keni mundësi të dribloni përgjatë koneve jeni plot me krenari dhe jo shumë të përlur? Nuk ka asgjë të gabuar që të jemi të sigurt se mund të bëjmë diçka. Kjo quhet siguri dhe është gjë e mirë. Le të shohim nëse mund të driblosh përgjatë këtyre koneve dhe përgjatë koneve të tjerë në kthim. Në rregull, NISU! Le ta inkurajojmë shokun/shoqen!

Mirë, kështu është kur ke siguri. Mund t'ia dalësh shumë mirë me siguri. Siguria në fakt ju ndihmon të luani më mirë. Megjithatë, a mund të ndodhë që të kemi siguri të tepëruar? Ky është momenti kur filloni të bëheni krenarë. Të gjithë kanë pika të forta dhe pika të dobëta. (Emri i kampistit) është i mirë në driblimin e topit të futbollit. Nëse mendojmë më tepër se duhet për aftësitë tona mund të bëhemi të verbër ndaj pikave tona të dobëta dhe atëherë fillojmë të dobësohemi në gjërat ku jemi mirë. Kur nuk mund të shohim sesi mund të përmirësohemi në fakt fillojmë të dobësohemi.

Tani do t'ia mbyll sytë (emri i kampistit). Do ta bëjmë këtë gjë sikur personi të jetë verbuar nga krenaria. Mirë, le t'i mbyllim sytë. Bibla në fakt flet për krenarinë në shumë vende dhe gjithashtu na flet sesi Perëndia na kërkon të jemi të përlur dhe të ecim me Të. Ka një varg tek Fjalët e Urta 16:18 që thotë, "Përpara shkatërrimit vjen kryelartësia dhe përpara rrëzimit fryma krenare." Prandaj le të shpresojmë që (emri i kampistit) nuk do rrëzohet. Janë mbyllur mirë sytë? Mirë, unë do jem këtu përkrah teje për të të ndihmuar që të mos rrëzohesh. A nuk tingëllon mirë kjo? Në rregull, gati je? Le ta inkurajojmë shokun/shoqen!

Ka shumë të ngjarë që kampisti do ngatërrohet, thjesht tregohuni të duruar me të dhe sigurohuni që të mos lëndohet. Pas pak kërkojini kampistit të ndalojë. Qëndroni pranë kampistit.

Në rregull! Të lumtë që u përpoqe të kaloje përgjatë pengesave. Më herët përmenda që Perëndia na kërkon të jemi të përlur dhe të ecim me Të. Mikea 6:8 thotë, "O njeri, ai të ka bërë të njohur atë që është e mirë; dhe çfarë tjetër kërkon Zoti nga ti, përveç se të zbatosh drejtësinë, të duash mëshirën dhe të ecësh përlësisht me Perëndinë tënd?" Kur kalojmë kohë me Perëndinë jemi në gjendje të shohim sa madhështor që është Ai dhe Ai na tregon sesi mund të jemi të përlur. Është sikur Ai e largon krenarinë nga zemra jonë në mënyrë që të fokusohemi tek ajo që kemi nevojë të mposhtim. Le ta heqim mbulesën e syve. Dole pak nga shtegu apo jo? Në rregull, le ta mbyllim si duhet! Gati, nisu.

Le t'i japim një duartokitje (emri i kampistit) ndërsa ai/ajo ulet në vend. Sot gjatë programit do të dëgjojmë pak më tepër rreth Nebukadnesarit dhe se çfarë i ndodhi atij kur jeta iu mbush me krenari. U desh që Perëndia t'i tregonte disa gjëra para se Nebukadnesari të përulej dhe të ecte me Perëndinë. Vazhdojmë!

HISTORIA BIBLIKE

Poshtërimi i Nebukadnesarit

Si jeni sot? Le të bëjmë një rikujtim për të parë nëse e mbajmë mend për çfarë kemi folur dy ditët e fundit. A mund të më thotë dikush se cila është tema jonë për këtë javë? Triumfo, e saktë. Po tema që studiuam të Hënë? (Për të triumfuar duhet të jemi të mësueshëm) Ideja kryesore nga e Hëna ishte që Perëndia është trajneri më i mirë për ju dhe për ekipin tuaj. Po tema e djeshme? (Për të triumfuar duhet të jemi të guximshëm) Cila ishte ideja kryesore? (Perëndia na jep guxim që të bëjmë gjënë e duhur).

Shumë mirë! Sot kemi qenë duke folur rreth temës: Për të triumfuar duhet të jemi të përlulur. A e di dikush se çfarë do të thotë të jemi të përlulur? (Të mos jesh krenar, të mos mendosh për veten si më i rëndësishëm se të tjerët, modesti, etj.). Nganjëherë mendojmë për dikë që fiton si dikush që është krenar apo mburravec me arritjet e veta, por në ekipin e Perëndisë është krejt e kundërta. Të jesh i përlulur do të thotë të vendosësh të tjerët përpara vetes dhe të dallosh që çdo gjë e mirë që bëjmë apo kemi vjen prej Perëndisë.

Perëndia sigurohet që të na thotë se çfarë pret nga ne: megjithatë ne ende veprojmë me kokën tonë dhe bëjmë gjënë e gabuar. Mbreti Nebukadnesar nuk ia vuri veshin asaj që Perëndia dëshironte por bëri atë që ai dëshironte! Në historinë e sotme atij iu tha nga Perëndia çfarë duhej të bënte dhe çfarë jo; megjithatë, ai vendosi që të mos e dëgjonte Perëndinë dhe bëri atë që dëshironte vetë. Ka pasoja kur ne vendosim të bëjmë sipas kokës tonë dhe të mos ndjekim Perëndinë. Ja si qëndron situata: kur bëjmë atë që duam vetë Perëndia është gjithmonë i gatshëm të na falë dhe na mirëpret që të jemi në një marrëdhënie me Të. Në fakt, nuk ka asgjë që mund të bëjmë ne për të fituar faljen për mëkatet tona. Vetëm Perëndia mund të na falë dhe Ai është gjithmonë i gatshëm!

Historia e sotme fillon me Mbretin Nebukadnesar që tregon historinë e tij – pak a shumë sikur ta kishte shkruar në ditar. Mbani mend, Mbreti Nebukadnesar ishte Mbreti i Babilonisë për një kohë shumë të gjatë. Në atë kohë Babilonia ishte mbretëria më e fuqishme mbi tokë. Babilonia është gjithashtu mbretëria që sulmoi Izraelin, vendin e Danielit dhe e mori atë rob bashkë me shokët e tij.

Mbreti Nebukadnesar, sikurse mund ta imagjinoi mendonte se ishte personi më i mahnitshëm që kishte ekzistuar ndonjëherë! Nëse ju kujtohet nga historia e djeshme ai ishte personi që ngriti statujën gjigante prej ari në mënyrë që njerëzit të përuleshin dhe ta adhuronin. Ai u përpoq t'i vriste shokët e Danielit, Shadrakun, Meshakun dhe Abednegonë; por Perëndia i mbrojt dhe i ndihmoi të dilnin fitimtarë.

Mbreti Nebukadnesar kishte problem me krenarinë. A mund të më thotë dikush se çfarë është krenaria? Krenaria është kur mendojmë se jemi më të rëndësishëm se të tjerët. Kjo mund të na bëjë të adhurojmë veten në vend të Perëndisë. Tani kemi arritur tek tema e ditës: për të triumfuar duhet të jemi të përlulur. Kjo mund të duket paksa e çuditshme. Kur mendojmë për dikë që është i përlulur nganjëherë na vete mendja tek dikush që nuk fiton apo dikush që është i dobët. Perëndia premton krejt të kundërtën: kur jemi të përlulur Ai do të na ndihmojë të fitojmë.

Le të shohim sesi e mësoi Nebukadnesari mësimin e sotëm. Ja sesi e fillon Nebukadnesari historinë e tij.

Lexoni Danieli 4:1-3

Duket sikur Nebukadnesari pësoi një ndryshim zemre dhe u bë i përlulur! Si ndryshoi nga një mbret krenar tek dikush që e lavdëroi Perëndinë si Mbretin e vërtetë? Le ta zbulojmë së bashku.

Lexoni Danieli 4:4-7

Nebukadnesari ishte duke u shlodhur në pallatin e tij. Imagjinoi si do ishte po të kishit një pallat të tërë për veten tuaj! Ai pa një ëndërr tjetër e cila e shqetësoi. A e mbani mend ëndrrën e tij të parë për të cilën kemi mësuar? Ëndrra e tij e parë tregonte për një statujë që ishte bërë prej materialesh të ndryshme dhe që u shkatërrua nga një gur që erdhi nga qielli. Kjo ëndërr i tregoi Nebukadnesarit që mbretëria e tij nuk do zgjaste përgjithmonë.

Nebukadnesari dukej sikur gjithmonë shihte ëndrra të çuditshme dhe ëndrra e tij e dytë ishte gjithashtu e çuditshme. Ishte aq e çuditshme saqë këshilltarët e tij nuk mundën t'ia interpretonin dot dhe iu desh që të thërriste Danielin i cili tani ishte kreu i këshilltarëve. Ja për çfarë bënte fjalë ëndrra e tij.

Nebukadnesari pa në ëndërr një pemë shumë të lartë saqë dukej se arrinte në qiell. Kjo ishte një pemë shumë

e fortë dhe kishte fryte shumë të mira. Të gjitha kafshët dhe njerëzit gjenin strehë nën hijen e pemës dhe hanin nga fryti i saj. Pastaj, erdhi një lajmëtar nga qielli dhe tha që pema do të pritej. Pema ishte si Nebukadnesari dhe simbolizonte sa e madhe ishte mbretëria e tij. Pasi të pritej kishte një kohë kur nuk u lejua që pema të rritej. Në fakt do kalonin shtatë stinë derisa Nebukadnesari ta humbiste krenarinë e tij dhe të bëhej njeri i përlulur përpara Perëndisë.

Mbreti Nebukadnesar nuk e dinte se çfarë kuptimi kishte ëndrra, por Danieli e dinte që ky nuk ishte lajm i mirë për Nebukadnesarin. Ja se çfarë i tha ai:

Lexoni Danieli 4:19-22

Danieli e interpretoi ëndrrën në këtë mënyrë: Mbreti Nebukadnesar ishte pema dhe mbretëria e tij ishte mbretëria më e madhe mbi tokë. Në këtë moment Babilonia kishte pushtuar pjesën më të madhe të botës dhe Nebukadnesari kujdesej për shumë popuj në mbretërinë e tij. Gjithë frytet e pemës përfaqësonin popujt në mbretërinë e tij. Danieli i tha Nebukadnesarit që ai kishte nevojë të kishte kujdes sepse krenaria e tij do ta fuste në telashe.

Perëndia na thotë diçka të ngjashme edhe ne. Cila është ideja jonë kryesore: Perëndia na kërkon të jemi të përlulur dhe të ecim me Të. Pasojat për ne nuk janë të njëjtat. Ne nuk jemi një pemë e madhe apo një mbretëri. Megjithatë, Perëndia na kërkon që ta përlulim veten. Është gjë e mirë që pasojat janë të ndryshme sepse për Nebukadnesarin ato ishin vërtet të çuditshme. Perëndia tha që ai do të çmendej, do sillej si kafshë dhe do të endej lart e poshtë në tokë. Perëndia po i thoshte Nebukadnesarit që të kërkonte falje, të përulej dhe të pranonte që Perëndia ishte në kontroll. Perëndia do t'ia kthente mbretërinë Nebukadnesarit sapo të përulej dhe të kërkonte falje. Ja këshilla e Danielit për Nebukadnesarin nëse ai dëshironte që ta evitonte gjithë këtë peripeci.

Lexoni Danieli 4:27

Kjo tingëllon mjaft e thjeshtë. Nebukadnesari kishte nevojë të bënte gjërat e duhura dhe të mos mëkatonte. Ai kishte nevojë të ishte i mirë me njerëzit që nuk ishin shumë të pasur apo që ishin të ndryshëm nga ai. Duket sikur unë mund ta bëja këtë në vend që të endesha përreth si kafshë! A mendoni se Mbreti Nebukadnesar e pranoi këshillën e Danielit? Fatkeqësisht ai nuk e pranoi.

Imagjinoni pak! Mbreti Nebukadnesar mori një paralajmërim nga Perëndia për të ndryshuar - për të kërkuar falje dhe për të mos vazhduar më në krenari.

Lexoni Danieli 4:28-32

Mbreti Nebukadnesar ishte në telashe. Ai bëri të kundërtën e asaj që duhej të bënte. Nebukadnesari vendosi të ishte krenar në vend që të përulej. Ai bëri atë që nuk duhej të bënte. Përveç kësaj ai përbuzi Perëndinë dhe tha që Babilonia ishte ndërtuar që ta bënte Nebukadnesarin të dukej i madh dhe jo Perëndinë! A i tha Perëndia që do të kishte pasoja? Po, dhe tani shohim pasojat që ndodhin! Dje diskutuam fjalën "mëkat." Ne thamë që mëkati ishte çdo gjë që mendojmë, themi apo bëjmë e cila e trishton Perëndinë. Në këtë rast shohim që Nebukadnesari mëkatoi dhe mëkati gjithmonë ka pasoja. Le të shohim se cilat ishin pasojat për Nebukadnesarin.

Lexoni Danieli 4:33

Çfarë rrëmuje! Nga mbreti më i pushtetshëm të kthehesh në një endacak që ha bar si kafshët dhe të dukesh shumë i egër. Kur mëkatojmë edhe ne përballemi me pasoja. Kur ne mëkatojmë ndahemi nga Perëndia dhe marrëdhënia jonë me të priset! Për Nebukadnesarin mëkati i tij ishte krenaria. Edhe ne mund të përballemi me krenarinë, ose mund të kemi mëkate të tjera, por të gjithë ne zgjedhim të bëjmë atë që duam vetë në vend që të dëgjojmë Perëndinë. Kur mëkatojmë, marrëdhënia jonë me Perëndinë thyhet dhe kemi nevojë të marrim falje për mëkatet tona në mënyrë që të kemi sërish një marrëdhënie të duhur me Perëndinë.

Fatmirësisht, për Mbretin Nebukadnesar dhe për ne ky nuk është fundi i historisë.

Lexoni Danieli 4:34-35

Kur Nebukadnesari u kthye tek Perëndia me përlulësi, u fal. Është shumë gjë e mirë që Nebukadnesari e pranoi Perëndinë si Mbretin e vërtetë. Kjo në fakt është ideja kryesore që dëshiroj ta mbani mend. Perëndia na fal kur jemi të përlulur dhe i kërkojmë falje Atij. Ai është gjithmonë i gatshëm. Bibla në fakt thotë, "Nëse i rrëfejmë mëkatet tona, Ai është besnik dhe i drejtë të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi."

Jo vetëm kaq, por Perëndia është i gatshëm të na falë para se t'i kërkojmë Atij. Romakëve 5:8 thotë, "Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne." Ne kemi nevojë të besojmë që Jezusi është e vetmja mënyrë që mëkatet tona të falen, por Perëndia e bëri këtë gjë shumë kohë më parë se ne të ndalonim së mëkatuari, sa e mrekullueshme që është kjo!

Kur luajmë sporte dallojmë nevojën për të qenë të përlur në mënyrë që të vazhdojmë të përmirësohemi dhe t'i trajtojmë të tjerët si duhet. Ne madje folëm për ekipin e Lester Siti që mendonin se ishin më të rëndësishëm nga sa ishin në të vërtetë dhe e humbën ndeshjen të cilën duhej ta kishin fituar! Ka shumë shembuj njerëzish në sport që janë krenarë. Kurdoherë që dikush fillon të bëhet krenar nuk është më një lojtar i mirë në ekip. Shumë herë kjo mund të shkaktojë probleme në ekip dhe i gjithë ekipi do ketë vështirësi. Prandaj, si mund të qëndrojmë të përlur kur luajmë sport? Si mund të vazhdojmë të përmirësohemi (dhe ndoshta të jemi më të mirë) e megjithatë të mos e konsiderojmë veten si më të rëndësishëm se të tjerët?

A jeni ju të përlur? Apo mos vallë iu pëlqen të zgjidhni të bëni atë që dëshironi? Kemi parë sesi krenaria mund të na ndajë nga ekipi dhe trajneri ynë! Prandaj, si mund të triumfojmë ndaj krenarisë? Është e rëndësishme që të jemi të përlur! Ne mund të triumfojmë kundër shumë gjërave kur jemi të përlur!

DITA KATËR

Pasqyra e Ditës

TEMA: Ji besues

HISTORIA BIBLIKE: Gropa e luanëve (Danieli 6)

PIKA KYÇE: Perëndia do na çlirojë përgjithmonë kur i besojmë Atij

HISTORIA E PERËNDISË: Perëndia ka pushtetin për të na çliruar

Lista e këngëve

1. I Believe in Jesus
2. Shine
3. Movin' Me
4. High Power
5. 10,000 Reasons
6. Inside My Heart

NXEMJA

Bravo për këtë javë të gjithë juve! Duket sikur të gjithë ne po mësojmë shumë rreth sporteve tona këtë javë. Sot do të vazhdojmë të mësojmë dhe të kënaqemi! Jam shumë i ngazëlluar t'ju shoh të gjithëve ju. Kur të them tre dua që të gjithë të themi njëzëri temën e javës. Do t'ju jap një ndihmë të vogël, është një fjalë që fillon me "T".

Një, dy, tre: TRIUMFO!

Ditën e parë mësuam që për të triumfuar duhet të jemi të... (mësueshëm). Ditën e dytë mësuam që për të triumfuar duhet të jemi... (guximtarë). Dje, mësuam që për të triumfuar duhet të jemi... (të përlur). Shumë mirë!

Sot do të mësojmë që për të triumfuar duhet të jemi besues.

Kush mund të më thotë se çfarë do të thotë të jesh besues?

Po, të jesh besues do të thotë të tregosh që ke besim në diçka. Ne kemi besim tek prindërit tanë që do të vijnë të na marrin kur të mbarojë kampi. Kemi besim tek trajnerët tanë që të na mësojnë aftësi të reja të cilat do na ndihmojnë të përmirësohemi. Kemi besim që shokët e ekipit do bëjnë më të mirën ndërsa luajmë së bashku. Kemi besim tek fusha që do të na mbajë ndërsa vrapojmë sipër saj. Ne tregojmë shumë besim në shumë gjëra përgjatë gjithë ditës!

A është zhgënjyer ndonjëherë dikush? A i keni besuar ndonjëherë një shoku një sekret i cili më pas i tregoi dikujt tjetër? A i keni besuar ndonjëherë një karrigeje, por kur u ulët në të ajo u thye? E di që unë vetë kam besuar në gjëra të cilat dolën që nuk ishin të besueshme!

Besimi është një ide e rëndësishme prandaj dua të sigurohem që ta kuptoni. Më lejoni t'ju bëj disa pyetje. Cilët janë disa njerëz të cilët i besoni? Kur bie fjala për sportin, a kemi nevojë të besojmë tek trajneri dhe tek strategjia e tij? Po!

Ditën e Hënë, folëm për zgjedhjen e trajnerit të duhur, dikush të cilit mund t'i besojmë. Ditën e Martë, folëm për të qenët i guximshëm, dhe pamë sesi shokët e Danielit i besuan Perëndisë me rezultatin edhe atëherë kur ishin të frikësuar. Dje pamë sesi krenaria e Nebukadnesarit e pengoi t'i besonte Perëndisë. Duket sikur ka një temë të përbashkët. Ekziston dikush tek i cili mund të kemi besim dhe që nuk do të na lërë kurrë në baltë!

A e merr me mend dikush se për kë e kam fjalën? Ai na krijoi të kishim një marrëdhënie me Të përgjithmonë si trajneri ynë. Ai na tregon se cilat gjëra do ta lëndojnë marrëdhënien tonë. Ai madje na jep guxim për ta mposhtur mëkatin tonë. Ai vazhdon të na dojë edhe kur krenaria na pengon. Sot do të flasim për mënyrën e

vetme sesi mund të kemi sërish një marrëdhënie me Perëndinë. Perëndia ka një plan dhe nëse i besojmë planit të Tij, që Jezusi na fali mëkatet, mund të kemi sërish një marrëdhënie me Perëndinë, tani e përjetë!

Në historinë biblike për sot do të shohim sesi Danieli i besoi Perëndisë dhe sesi Perëndia e çliroi nga një situatë e tmerrshme. Do të mësojmë gjithashtu sesi Perëndia do të na çlirojë përgjithmonë kur i besojmë Atij.

Le ta nisim këtë ditë të re në kampin e sportit me një lutje.

HISTORIA E SPORTIT

Simone Biles

Besimi është një përbërës i rëndësishëm për çdo ekip. Edhe nëse është diçka e thjeshtë si të besosh që shoku i ekipit të ta pasojë topin në momentin e duhur ose të besosh strategjinë e trajnerit. Që të dyja këto janë shumë të rëndësishme pothuaj në çdo lloj sporti. Cilët janë disa njerëz të tjerë të cilëve mund t'u besojmë në jetën tonë?

Shumica nga ne mund t'u besojmë prindërve tanë. Fatkeqësisht ka raste kur nuk mund t'u besohet prindërve. Shumë herë kjo ndodh për shkak të situatave të ndryshme dhe asaj që ka përjetuar prindi, herë të tjera është për shkak të zgjedhjeve të gabuara nga ana e prindërve. Kjo është e vërtetë edhe për mamin e Simone Biles. Kur Simon Biles ishte vajzë e vogël nëna e saj nuk mund të kujdesej dot më për të prandaj ajo shkoi të jetonte me gjyshërit e saj, Ron dhe Nellie Biles.

Pavarësisht se nuk ndihej e aftë për t'u besuar shumë njerëzve, ajo zbuloi që mund të besonte se gjyshërit e saj donin më të mirën për të. Kur ishte gjashtë vjeç, Ron dhe Nellie e birësuan Simonën dhe motrën e saj më të vogël dhe kështu ajo u bë anëtare e familjes së tyre. Roni dhe Nelli bënë një punë të mrekullueshme për t'i integruar vajzat në familjen e tyre dhe madje Simona thotë, "Kur isha më e vogël, mendoja që të gjithë fëmijët ishin të birësuar. Nuk e kuptoja pse njerëzit e bënin kaq gjë të madhe. Për mua ishte thjesht normale."

Shumë shpejt pasi u birësua Simone filloi të ushtrohej në gjimnastikë përkrah Emi Borman (Aimee Boorman). Që në moshën 8 vjeçare Simona u trajnuar nga Emi Borman dhe i duhej të besonte që udhëzimet e trajneres do ta ndihmonin të bëhej gjithnjë edhe më e mirë si gjimnaste. Nuk ka dyshim që Simona u përmirësua. Kur ajo ishte 14 vjeç Simona po konkuronte në disa ngjarje kombëtare dhe trajneria e saj Emi ishte përkrah saj.

Në gjimnastikë duhet të jesh në gjendje t'i besosh trajnerit dhe stërvitjes. Kur vjen momenti për konkurim duhet të jesh në gjendje të besosh që trajneri të ka përgatitur. Pa këtë besim mund të lëkundesh gjatë një ushtrimi rutinë dhe kështu të harxhosh kot mundësinë që ke për sukses.

Pjesëmarrja në lojërat Olimpike të vitit 2016 në Rio ishte një sfidë e madhe për Simone Biles. Ajo kishte fituar tre Kampionatet e fundit Botërore në disa ushtrime të ndryshme dhe pritej që edhe kësaj here të fitonte medaljen e artë. Ajo do përpiqej të fitonte pesë medalje të arta, më shumë se ka fituar dikush tjetër ndonjëherë në gjimnastikë. Në garën e saj të tretë të rëndësishme Simone u përball me një pengesë të madhe për planin e saj për të fituar pesë medalje ari. Në traun e ekuilibrit Simone u përpoq të kryente tre lëvizje të ndryshme dhe të vështira që në fillim të rutinës së saj dhe rrëshqiti pak ndërsa bëri lëvizjen e quajtur "goditja ballore". Rrëshqitja e saj u llogariti si rënie prandaj ajo duhej të mjaftohej me medaljen e bronzit në garën e traun të ekuilibrit.

Në këtë moment, kishte dhe një garë të fundit! Simone ose mund të fillonte të dyshonte tek trajneria dhe stërvitja e saj për shkak se u lëkund më parë, ose mund t'i besonte trajneres Emi dhe planit që kishin bërë bashkë për ushtrimin e dyshemesë. Simone mund të ketë patur arsye për të dyshuar. Ajo po provonte të bënte një prej ushtrimeve më të vështira në dysheme. Vlerësimi i vështirësisë do ta vendoste atë në një vend shumë më të lartë se konkurentet e tjera për aq kohë sa ajo nuk gabonte por qëndronte me planin.

Kjo garë ishte pak pas asaj në traun e ekuilibrit, por Simone thotë që nuk ishte në siklet dhe kishte besim të plotë tek mënyra sesi trajneria e saj e kishte përgatitur. Gjatë ushtrimit të dyshemesë Simone bëri katër lëvizje të ndryshme të cilat përfshinin disa prej kërcimeve dhe lëvizjeve më të mahnitshme në ajër që ishin parë ndonjëherë në sportin e gjimnastikës. Ajo pati besim tek stërvitja e saj dhe kjo bëri që ajo të fitonte medaljen e artë në ushtrimin e dyshemesë!

Ka dhe një vend tjetër ku Simone ka vendosur besimin e saj. Simone beson në Perëndinë me jetën e saj, jo vetëm për gjimnastikën, por edhe për vetë jetën e saj të përjetshme. Simone beson që Jezusi është Udhë, e Vërteta dhe Jeta. Më vonë do të flasim për Danielin dhe sesi ai i besoi Perëndisë për jetën e tij edhe kur u përball me vdekjen e sigurtë.

Ne gjithashtu kemi mundësi që të besojmë në Jezusin. Ne mund ta dimë që Ai na do dhe dëshiron që të jemi me Të përgjithmonë. Sa mënyrë e mirë për të mposhtur dyshimin dhe frikën: të dish që Jezusi do na mbrojë për gjithë përjetësinë dhe do të na mbajë në një marrëdhënie të ngushtë me veten e tij përgjithmonë!

SHEMBULL MËSIMI

Të kesh besim për Çmimin

Përshëndetje të gjithëve! Si po ia kaloni? Si ishte koha duke luajtur sport? Jam i gëzuar që mund ta ndaj këtë shembull mësimi me ju sot, por kush mund të më thotë se për çfarë kemi qenë duke folur gjithë këtë javë? Ne kemi qenë duke folur sesi të triumfojmë. Sot do të flasim për një nga mënyrat më të mira për të triumfuar. Duhet të besojmë. Kemi nevojë të besojmë tek njerëzit e tjerë që të triumfojmë mbi shumë gjëra në jetë.

Trajneri mund të na ndihmojë me kundërshtarin duke na dhënë një strategji për lojën, por ne duhet të kemi besim që strategjia apo plani do të funksionojë. Duhet të besojmë që anëtarët e ekipit tonë do jenë aty kur t'ua pasojmë topin. Ka shumë mënyra sesi u besojmë njerëzve në sport. Inkurajimi nga tifozët është një mënyrë shumë e mirë ku e shohim këtë besim. Vajzat që ngrihen lart duhet të kenë besim që baza do t'i mbajë si duhet në mënyrë që të mos rrëzohen.

Besimi është i rëndësishëm edhe jashtë sportit. Shumë prej nesh mund t'u besojmë prindërve tanë. Shpesh u besojmë shokëve tanë por ekziston një person të cilit mund t'i besojmë gjithmonë. Ne mund t'i besojmë Perëndisë për gjithçka!

Mund t'i besojmë gjithmonë Jezu Krishtit që të na i falë mëkatet. Në fakt, Jezusi është i vetmi person të cilit mund t'i besojmë që të na falë mëkatet tona dhe të rregullojë marrëdhënien tonë me Perëndinë. Kur besojmë që Jezusi vdiq për mëkatet tona dhe u ringjall sërish, e dimë që mund të jetojmë me Perëndinë në një marrëdhënie të përsosur përgjithmonë. Qielli është dhurata që marrim nga besimi në Perëndinë.

Sot kam një dhuratë këtu me vete. Nuk mund të krahasohet fare me qiellin, por si dhuratë do jap [emri i dhuratës]. Në mënyrë që ta fitoni këtë çmim dëshiroj që të dalë përpara një person që është në gjendje të bëjë tre gjëra: pesë pompa, pesë kërcime së larti dhe pesë kërcime në formë ylli. Ka ndonjë që mendon se mund t'i bëjë këto? Në rregull, eja këtu....

Tani që do të përpara duhet të dish që nuk do jesh t'i ai që do t'i bëjë ushtrimet për të marrë çmimin. (Prisni për disa momente në qetësi.) Vërtet mendoj që mund t'i bësh ato. Megjithatë, për të marrë çmimin duhet t'i besosh dikujt tjetër që t'i bëjë këto ushtrime për ty. Mund të zgjedhësh një shok që dëshiron ta pranojë sfidën dhe tek i cili ke besim që do ta fitojë çmimin për ty.

Kjo i bën gjërat të jenë paksa ndryshe apo jo? Duhet të sigurohesh që mund ta vendosësh besimin tek personi i duhur. Kur bie fjala për jetën e përjetshme duam të sigurohemi që ta vendosim besimin tonë tek personi i duhur!

Në rregull, kë do të zgjedhësh që t'i bëjë ushtrimet për ty? Shkëlqyeshëm! [Shoku i kampistit] të lutemi eja këtu përpara! Në rregull, ne të gjithë do bëjmë tifo për [shoku i kampistit] dhe do të shohim nëse do t'i bëjë pesë pompat, pesë kërcimet së larti dhe pesë kërcimet në formë ylli. Gati, fillo!

Shumë mirë. Duket sikur e vendose besimin tek personi i duhur dhe për këtë arsye do ta marrësh çmimin. E njëjta gjë edhe kur flasim për mëkatin dhe të qenët të ndarë nga Perëndia. Duhet t'i besojmë Jezusit që pagoi çmimin për mëkatin tonë duke vdekur në kryq dhe duke u ringjallur prej së vdekuri.

HISTORIA BIBLIKE

Gropa e Iuanëve (Danieli 6)

Shpresoj që po kaloni një të Enjte të mrekullueshme! Unë për vete jam kënaqur me të gjitha ushtrimet e sportit dhe jam kënaqur edhe më tepër duke folur për shokun tonë Danielin. Para se të futemi në historinë e sotme le të shohim nëse mund të mbajmë mend se për çfarë kemi folur deri tani.

Tema jonë për këtë javë është të triumfojmë dhe si mund ta bëjmë këtë, duke qenë në ekipin e Perëndisë ne mund të mposhtim të gjitha pengesat. A e mban mend dikush se cila ishte tema e ditës së Hënë? (Për të triumfuar duhet të jemi të mësueshëm.) Shumë mirë! Le të shohim kush mund të më thotë se cila ishte tema e ditës së Martë? (Për të triumfuar duhet të jemi guximtarë.) Fantastike! Kush ishte këtu dje dhe mund të më thotë temën? (Për të triumfuar duhet të jemi të përlurur.) Ju paskeni një kujtesë shumë të mirë! Çfarë pengesash kanë kaluar Danieli dhe shokët e tij deri tani? Të hanin ushqim të keq, të bënin gjëra të pamundura, një furrë e zjarrtë dhe një mbret i çmendur. Më e rëndësishmja është që ata vazhdojnë ta mundin ligësinë dhe mëkatin në jetën e tyre! Ata vazhdojnë të mbështeten në Perëndinë dhe Ai vazhdon t'i ndihmojë t'i mposhtin gjërat e këqija.

Historia e sotme përqendrohet në vargun e temës tonë: Për të triumfuar duhet të tregojmë besim.

A mund të dalë dikush dhe të na e thotë vargun e javës?

Shkëlqyeshëm, tani le ta provojmë të gjithë së bashku!

(Përdorni pjesën e titulluar, Mësimi Përmendësh i Vargut)

Shumë herë kur ka gjëra në jetën tonë që duhet t'u besojmë njerëzve të tjerë që të na ndihmojnë për të na shpëtuar. Ka shumë lloje të ndryshme shpëtimi dhe mënyra sesi mund të shpëtohem – goftë kur kemi vështirësi në shkollë ose kemi humbur në pyll – kemi nevojë për ndihmë nga të tjerët. Danieli u përball me këtë gjë shumë herë në jetën e tij dhe një histori në mënyrë të veçantë tregon sesi Danieli kishte nevojë të shpëtohej nga një situatë e pamundur. Një gjë në lidhje me rastet kur Danieli u shpëtua ishte që ai (apo shokët e tij) vendosën besimin e tyre në Perëndinë.

Në momentin ku fillon historia e sotme Danieli ishte burrë plak. Ai u kishte shërbyer dy mbretërve deri tani dhe sapo kishte filluar t'i shërbente një mbreti të tretë të quajtur Dar. Danieli kishte vazhduar të përqendrohej tek Perëndia dhe t'i besonte Atij përgjatë gjithë situatave. Për shkak se kishte qenë kreu i këshilltarëve për shumë mbretër dhe për një kohë të gjatë kishte njerëz që ishin xhelozë për Danielin dhe nuk e pëlqenin atë. Armiqtë e tij sajuan një plan: ata donin të zinin vendin e tij si kreu i këshilltarëve dhe për këtë duhej ta bënin mbretin që të mos e pëlqente më Danielin. Nganjëherë kur njerëzit janë të suksesshëm, njerëz të tjerë janë xhelozë për ta dhe dëshirojnë që ata të humbasin atë që kanë. Kjo nuk është diçka që duhet ta bëjmë kur jemi në ekipin e Perëndisë. Kur jemi në ekipin e Perëndisë duhet të jemi të lumtur kur të tjerët janë të suksesshëm dhe të mos dëshirojmë atë që kanë të tjerët dhe as të dëshirojmë të keqen e tyre. Këshilltarët e tjerë nuk ishin në ekipin e Perëndisë dhe prandaj sajuan një plan të keq. Le të lexojmë se cili ishte plani i tyre:

Lexoni Danieli 6:4-5

Danieli ishte burrë i mirë: ata nuk mundën të gjenin ndonjë gjë që ai e kishte bërë gabim! Ai vazhdoi ta mundte mëkatin. Megjithatë, ata vendosën të tregohen dinakë në mënyrë që ta futnin në telashe.

Lexoni Danieli 6:6-9

Kjo është vërtet dinakëri. Ata që do i luteshin dikujt tjetër përveç Mbretit Dar do të hidheshin në gropën e Iuanëve. A do konsiderohej kjo gjë mëkat? Po, kjo do të thotë të vendosësh dikë mbi Perëndinë. Situata ndryshoi shumë shpejt! Dari ishte krenar, prandaj mendoi që lutjet drejtuar atij do ishin një ide e mirë. Ai nuk mendoi shumë për pasojat. Dari i besoi asaj që thanë këta persona. Ky nuk ishte vend i mirë për ta vendosur besimin. Prandaj ai e firmosi ligjin! Sipas ligjit të Babilonisë sapo të miratohej plani dekreti nuk mund të ndryshohej për tridhjetë ditë.

A keni qenë ndonjëherë në telashe kur nuk ishte faji juaj? Kjo nuk është asnjëherë gjë e këndshme!

Armiqtë e Danielit e ngritën grackën e tyre dhe pastaj pritën të shihnin se çfarë do bënte Danieli. Çfarë mendoni se do të bënit ju? Për vete e di që do ishte e vështirë të vazhdoja të isha i guximshëm për të bërë gjënë e duhur.

Lexoni Danieli 6:10

Ky është vërtetë guxim! Danieli vazhdoi të bënte atë që kishte bërë gjithmonë: ai u lut tre herë në ditë. Ai vazhdoi të besonte që Perëndia do të kujdesej për të! Burrat që donin t'i zinin vendin Danielit erdhën dhe e gjetën duke u lutur dhe këtë gjë ia raportuan Mbretit Dar.

Lexoni Danieli 6:14-15

Mbreti Dar kuptoi çfarë kishte bërë dhe u përpoq ta ndryshonte, por nuk mundej! Atij i duhej që ta hidhte Danielin në gropën e luanëve. A mund ta imagjiloni dot sesi u ndje ai në atë moment?

Lexoni Danieli 6:18

Danieli kishte nevojë për çlirim. Mendoni pak për këtë gjë: të të hedhin në një gropë të mbushur me luanë të uritur. Nuk kishte asnjë mënyrë sesi Danieli të mbijetonte nëse Perëndia nuk ndërhynte dhe ta shpëtonte. Danieli i besoi Perëndisë dhe bëri gjënë e duhur duke iu lutur Atij. Danieli kishte nevojë që Perëndia ta çlironte. Ai e kuptoi që e kishin mashtruar, por nuk mund ta ndryshonte ligjin për 30 ditë!

Në këtë pozitë jemi edhe ne kur mëkatojmë. Nuk ka asgjë që mund të bëjmë për të fituar faljen. Nuk mund të jemi mjaft të mirë. E vetmja gjë që mund të bëjmë është që të presim çlirim. Perëndia nuk na çliron vetëm për pak, Ai na çliron përgjithmonë! E mbani mend se cilat janë pasojat e mëkatit? Ndarje prej Perëndisë përgjithmonë. E vetmja mënyrë sesi mund të kemi sërish një marrëdhënie me Perëndinë është nëse Ai na shpëton! Kjo në fakt është ideja jonë kryesore për sot: Perëndia na çliron përgjithmonë kur i besojmë Atij. Bibla flet për këtë gjë herë pas here. Efesianëve 2:8-9 thotë, "Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush." Danieli e dinte që kishte nevojë të shpëtohej. A mendoni se Danieli u mbështet në fuqinë e vet apo në Perëndinë? Ai i besoi Perëndisë!

Lexoni Danieli 6:19-22

Danieli ishte në ekipin e Perëndisë, i kërkoi Perëndisë që ta shpëtonte dhe Perëndia e mbrojti atë nga luanët. Ai madje nuk pësoi as edhe një gërvishtje! Në realitet, nuk ishte aq shumë që Danieli fitoi mbi këtë situatë, por që Perëndia e mposhti këtë situatë për të. Të gjitha historitë tona këtë javë tregojnë sesi mund të fitojmë me ndihmën e Perëndisë! Kjo është arsyeja pse tema jonë e parë ishte që të jemi të mësueshëm. Ne duhet të mbështetemi në Perëndinë dhe t'i besojmë planit të Tij!

Edhe Mbreti Dar kishte disa gjëra të mira për të thënë për Perëndinë:

Lexoni Danieli 6:25-28

Pasi pa gjithë sa Perëndia kishte bërë për Danielin, Mbreti Dar e dalloj sa i madhërishtëm është Perëndia. Ai e dalloj që besimi në Perëndinë ishte gjëja më e rëndësishme. Vetëm Perëndia është mjaft i madh sa për të na shpëtuar, dhe ne gjithmonë mund të besojmë tek Ai dhe tek plani i Tij. Ja ideja qëndrore: ne të gjithë jemi në një situatë të pamundur, e dimë apo nuk e dimë këtë gjë. Cila është situata jonë e pamundur? Mëkati ynë na ndan nga marrëdhënia me Perëndinë. Megjithatë, Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të na shpëtojë dhe ta ripërtërijë marrëdhënien tonë me Perëndinë. Më lejoni t'ju tregoj pak më tepër sesi ta bëjmë këtë gjë.

Filloni prezantimin e Ungjillit duke përdorur mjetin tuaj të preferuar për tregimin e Ungjillit. Prezantoheni Ungjillin në mënyrë të plotë, të saktë dhe të qartë. Për ide ju lutemi kontaktoni me Base Sports! www.basesports.org

DITA PESË

Pasqyra e Ditës

TEMA: Ji shpresues

HISTORIA BIBLIKE: Ëndërrat / Përmbledhje (Danieli 7)

PIKA KYÇE: Perëndia na ka dhënë të gjithëve ne shpresë për të ardhmen

HISTORIA E PERËNDISË: Shpresa e Perëndisë fillon tani dhe vazhdon në të ardhmen

Lista e këngëve

1. Inside My Heart
2. High Power
3. I Believe in Jesus
4. Nothing Better
5. 10,000 Reasons
6. Brave

NXEMJA

Jam shumë i trishtuar që kjo është dita jonë e fundit në kamp! Do më marrë malli t'ju shoh çdo ditë dhe të mësojmë më tepër për sportet dhe për Perëndinë.

Megjithatë, kampi ende nuk ka mbaruar! Kemi edhe një ditë së bashku! Sot, do të mësojmë gjënë e fundit që kemi nevojë të bëjmë për të triumfuar. Para se ta bëjmë këtë le të shohim gjithë gjërat që kemi mësuar. Kjo do të na ndihmojë me gjënë e fundit për të cilën do mësojmë sot.

Ditën e parë, mësuam që për të triumfuar duhet të jemi të mësueshëm! Ditën e dytë mësuam që për të triumfuar duhet të jemi të guximshëm! Ditën e tretë, mësuam që për të triumfuar duhet të jemi të përlulur! Dje mësuam që për të triumfuar duhet të kemi besim!

Disa prej jush dje keni marrë një vendim për të besuar në Jezusin për herë të parë, gjë e cila më ngazëllon së tepërmi! Marrja e atij vendimi u jep shpresë në një marrëdhënie të mirë me Perëndinë përgjithmonë! Të gjitha gjërat që mësuam për Perëndinë këtë javë na japin gjithashtu shpresë. Ky është elementi ynë i fundit për të fituar. Në mënyrë që të triumfojmë duhet të jemi shpresues!

Çfarë do të thotë të kesh shpresë?

Shpresë do të thotë të presësh gjëra të mira në të ardhmen. Shpresë do të thotë që edhe kur ndodhin gjëra të vështira në jetën tonë, ne besojmë që Perëndia do të na vijë në ndihmë që të triumfojmë! Nëse të triumfosh do të thotë të kesh sukses edhe kur ka problem apo vështirësi, të kesh shpresë do të thotë të presësh që përtej problemeve dhe vështirësive na presin gjëra të mira.

Shumë prej jush filluat të luani sport këtë javë në kamp. Në jetë, do të njihni lojtarë që janë më të mirë se ju. Në mënyrë që të triumfoni dhe të bëheni lojtarë më të mirë duhet të shpresoni që do të përmirësoheni edhe më tepër ndërsa stërviteni. Pa shpresën që mund të përmirësoheni nuk ka kuptim që të përpiqesh.

Kur vjen një problem apo vështirësi e madhe në jetën tonë mund të shpresojmë që gjërat do të përmirësohen dhe kjo na ndihmon që të fitojmë. Kjo është në mënyrë të veçantë e vërtetë kur e vendosim shpresën tonë në Perëndinë! Do të flasim më tepër për shpresën në Perëndinë gjatë kësaj dite! Shpresoj që sot do të argëtohem shumë! Pra, çfarë kuptimi ka kjo? Pres që të gjithë ne të argëtohem ditën e fundit të kampit të sporteve!

HISTORIA E SPORTIT

Patrick Anderson

Sot do të flasim për shpresën. Është e rëndësishme të kemi shpresë në jetën tonë e cila do të na ndihmojë të triumfojmë mbi vështirësitë. Pa shpresë, disa nga situatat më të vështira mund të duken të pamundura për t'u mposhtur. Sot, do të flasim për dikë të cilit iu desh të mposhte diçka shumë të vështirë. Atij i duhej që të kalonte një kufizim fizik. A mund të më tregojë dikush se çfarë është një kufizim fizik? Sipas fjalorit, një kufizim është një gjendje fizike që i kufizon lëvizjet, ndjesitë apo aktivitetet e personit. A njihni dikë që ka një kufizim?

Ne të gjithë kemi aftësi të ndryshme apo jo? Lajmi i mirë është që Perëndia e do secilin prej nesh pavarësisht se çfarë mundemi të bëjmë apo jo.

Ne të gjithë përballemi me situata të cilat na duken të pamundura dhe ndonjëherë mund të kemi dëshirë që të dorëzohemi. Patrik Anderson ishte nëntë vjeç kur në një aksident hyni të dyja këmbët e tij nga gjuri e poshtë. Para aksidentit Patriku i pëlqente të vraponte dhe të luante sporte. Ai kishte frikë që nuk do kishte mundësi të luante më në jetën e tij. Për një farë kohe ishte shumë i trishtuar dhe i frikësuar ndërsa po mësonte sesi të jetonte pa këmbët e tij. U përpoq të përdorte proteza për të ecur pa përdorur karrocën por protezat e lëndonin shumë dhe për këtë arsye iu desh të hiqte dorë nga të ecurit. Patriku thotë që kisha e tij luajti një rol të madh në ripërtëritjen e tij. Perëndia i dha shpresë për të ardhmen dhe ai vazhdoi të shpresonte që Perëndia kishte një qëllim për jetën e tij.

Ndërsa mësoi të përdorte karrocën, drejtori i shkollës së tij e ftoi në një kamp basketbolli për njerëz që përdorin karroca! Ai nuk kishte menduar që të luante sport për një kohë të gjatë por zbuloi që i pëlqente basketbolli me karroca. Kjo i dha ca shpresë që të vazhdonte të bënte atë që i pëlqente!

Ne mund të shpresojmë për shumë gjëra, por sikurse mësuam dje, vendi më i mirë për të vendosur shpresën tonë është në Jezusin. Patriku e bëri këtë gjë me komunitetin e kishës së tij dhe gjeti shpresë në Perëndinë dhe në lojën e basketbollit. Patriku ishte vetëm 17 vjeç kur e zgjodhën të luante në Ekipin Kombëtar Kanadez. Kur Patriku luajti në Lojërat Paraolimpike të vitit 2012 kishte arritur një karrierë të mahnitshme, kishte fituar shumë medalje dhe kampionate. Një nga lojërat e tij më të mira ishte në finalen e Lojërave Paraolimpike 2012 kundër Australisë. Në fillim të setit të katërt rezultati ishte i barabartë 48-48. Në këtë moment, duke e ditur që kjo ishte ndeshja e tij e fundit; Patrik Anderson vendosi t'i jepte ekipit të tij shpresë duke dhënë shembullin kur ata kishin nevojë për të. Patriku filloi të përfshihej në sa më shumë aksione që të kishte mundësi!

Në basketbollin me karroca është gjë e zakonshme të rrëzohesh. Edhe pse je i lidhur dhe nuk bie nga karroca, ende kërkohet shumë forcë për t'u ngritur dhe për të vazhduar lojën. Gjatë ndeshjes, kjo gjë i ndodhi Patrikut. Ai thjesht çohet dhe vazhdonte. Ai e dinte që gjërat mund të ishin sfiduese, por gjithashtu e dinte që nëse çohet dhe vazhdonte do vinin kohë të mira. Kjo është shpresë! Nga ai moment e në vazhdim Patriku nuk ndalej. Ai shënoi 34 pikë, mbështeti 10 aksione, dhe 8 topa të fituar nga tabela, dhe kështu e ndihmoi ekipin e tij të fitonte medaljen e artë!

Puna e Patrik Andersonit në basketbollin me karroca vazhdon t'u japë shpresë mijëra njerëzve. Më vonë do të flasim sesi Perëndia na jep shpresë. Ne kemi shpresë sepse shohim sa besnik që është Perëndia kur shohim ngjarjet në Bibël. Shumë njerëz e shohin Patrikun që luan basketboll dhe mendojnë sesi edhe ata mund të luajnë sërish basketboll edhe nëse kanë kufizime. Bibla na tregon se ku kanë ndodhur gjëra të mëdha për shkak të Perëndisë dhe gjithashtu na tregon pse mund të vazhdojmë të kemi besim në Perëndinë. Historitë tona për Danielin gjatë kësaj jave na kanë treguar sesi Perëndia mund të na japë shpresë dhe të na ndihmojë që të mposhtim shumë pengesa në jetën tonë ndërsa fokusohemi gjithnjë e më tepër tek Ai!

SHEMBULL MËSIMI

Përgatitja: Top futbollit ose basketbollit i fryrë dhe një pompë me gjilpërë

Kur jemi plot me shpresë kjo gjë mund të na ndihmojë të bëjmë gjëra të mahnitshme. Kjo është në mënyrë të veçantë e vërtetë kur shpresojmë në vendin e duhur. Dje disa prej jush mund ta kenë vendosur shpresën e tyre në Jezusin. Një nga gjërat interesante rreth kësaj është që tani kemi shpresë në shumë gjëra, dhe në mënyrë të veçantë për të ardhmen. Kemi shpresë që do të jetojmë me Perëndinë përgjithmonë! Sa e mrekullueshme është kjo?

Jam i sigurt që kur Danieli dhe shokët e tij u gjendën në situata të frikshme patën shpresë që Perëndia do t'i mbronte. A e dinin ata që në fakt do të kishte zgjidhje? A jua kishte dhënë Perëndia të gjitha copëzat e planit të tij? Jo! Ata nuk e dinin që do ishin mirë. Ata e vendosën shpresën e tyre në Perëndinë dhe u siguruan që të jetonin sipas asaj që Ai u kishte thënë.

Për ta demonstruar këtë ide të shpresës dhe sesi na ndikon ne kam këtu një top dhe një gjilpërë. Ky top plot me ajër na prezanton ne kur jemi plot me shpresë! Tani kam nevojë për një vullnetar. Dikush që mund ta përplasë këtë top shumë mirë. Dakord, eja këtu, [emri i kampistit]! Sa mirë funksionojmë kur jemi plot me shpresë dhe i mbajmë sytë të fokusuar tek Jezusi? Le ta shohim, [emri i kampistit] fillo që ta përplasësh topin!

Sa mirë funksionojmë kur jemi plot me shpresë dhe i mbajmë sytë të fokusuar tek Jezusi? Le ta shohim, [emri i kampistit] vazhdo të përplasësh topin.

Cilat janë disa gjëra që mund të na shpërqëndrojnë nga fokusimi ynë në Perëndinë? Çfarë mund të themi për të qënurit i famshëm? A është e mundur që të fokusohemi më tepër tek kjo sesa në Perëndinë? Prandaj le ta shfryjmë paksa topin.

Shfryjeni topin dhe kthejani kampistit... lejojeni atë që të vazhdojë ta përplasë topin në tokë?

Nuk po funksionon? A po bëhet më e vështirë?

Mirë, çfarë është diçka tjetër që mund të na shpërqëndrojë nga Perëndia? Saktë. Sportet mund të na shpërqëndrojnë nga ndjekja e Perëndisë. Prandaj le të nxjerrim pak më tepër ajër nga topi. A kërcen topi tani?

Dakord, prandaj tani këtu kemi një pompë që mund ta fryjë sërish topin. Cilat janë disa mënyra përmes të cilave mund të mësojmë që të kemi shpresë në Perëndinë? Leximi i Biblës, po e vërtetë! Le ta frymë pak topin... Fryjeni pak topin dhe kthejani kampistit. A po funksionon pak më mirë tani? Mirë, cilat janë disa gjëra të tjera që mund t'i bëjmë për të kujtuar sa shumë mund t'i besojmë Perëndisë dhe ta vendosim shpresën tonë në të?

Përgjigje të shkëlqyera! Ndërsa kampistët përgjigjen vazhdoni ta fryni topin edhe më shumë. Le të shohim tani sesi do funksionojë. Kthejani topin plotësisht të fryrë kampistit. Si kërcen topi tani?

Është e rëndësishme që të qëndrojmë të lidhur me Perëndinë dhe të kujtojmë pse mund të shpresojmë që Ai është gjithmonë me ne. Ne kemi shpresë në Të sepse sikurse tha dhe Jezusi në Bibël, "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta, askush nuk vjen tek Ati veçse nëpërmjet meje." Kur shpresojmë në Të do jemi me Perëndinë përgjithmonë. Edhe këtu në tokë, Perëndia dëshiron të na ndihmojë në mënyrë që të jetojmë jetën që Ai dëshiron të jetojmë. Jetët tona janë më të mira kur kemi shpresë dhe kur nuk harrojmë punën e Perëndisë për ne!

Le të bëjmë një përmbledhje! Cilat janë disa mënyra sesi mund të qëndrojmë të fokusuar në Perëndinë? Që të gjitha janë përgjigje shumë të mira! Të gjitha ato gjëra mund të na kujtojnë sa i madh është Perëndia dhe se çfarë ka bërë Ai. Këto na ndihmojnë të shpresojmë që Ai mund të na ndihmojë të triumfojmë!

HISTORIA BIBLIKE

Ëndrrat/ Përmbledhje (Danieli 7)

Kemi arritur në ditën e fundit të kampit! Jam kënaqur shumë duke u shoqëruar me të gjithë ju, duke mësuar gjëra shumë të mira për sportin dhe marrëdhënien me Perëndinë. E di që disa prej jush keni marrë disa vendime shumë të rëndësishme dhe, si duke u bërë pjesë e ekipit të Perëndisë duke besuar në Jezusin ashtu dhe duke vendosur t'i besoni Perëndisë në një zonë të jetës tuaj ku nuk i kishit besuar më parë. Siqo të jetë, kjo gjë më ngazëllon së tepërmi të di që jeni pjesë e ekipit të Perëndisë.

Le të shohim sesi Perëndia mund të na ndihmojë që të fitojmë sërish. A mund të më thotë dikush katër gjërat për të cilat kemi folur deri tani? Çfarë na nevojitet për të fituar? Duhet të jemi të mësueshëm, guximtarë, të përlurur dhe të besojmë. Shumë mirë!

Tema jonë për ditën e fundit të kampit është kjo: Për të triumfuar duhet të shpresojmë. Në botë ka shumë probleme dhe shumë njerëz të lënduar. Është e lehtë të shkurajohesh dhe të frikësohesh nga gjithë gjërat e këqija që ndodhin. Perëndia na bën premtime që gjërat nuk do jenë gjithmonë kaq keq, dhe ne mund të kemi shpresë sepse e dimë që Perëndia gjithmonë i mban premtimet.

Sot do të flasim sesi Perëndia i dha Danielit shpresë dhe sesi edhe ne mund të kemi shpresë në jetën tonë. Një nga mënyrat më të mëdha sesi mund ta dimë që mund të kemi shpresë është duke parë në Bibël shembujt e njerëzve që bënë gjëra vërtet të mrekullueshme me ndihmën e Perëndisë. Gjithë këtë javë kemi qenë duke parë Danielin, por në Bibël ka shumë më tepër histori të cilat tregojnë sesi Perëndia mund të na japë shpresë. Dje kemi folur sesi Jezusi i solli shpresë gjithë botës. Një nga mënyrat më të mira për të ditur që mund të kemi shpresë është duke parë Danielin. Le të shohim sërish disa nga mënyrat që Perëndia e përdor Danielin për të na treguar sesi ne mund të kemi përgjithmonë shpresë në Të!

Për ta bërë këtë gjë dëshiroj të shohim pas historitë e Danielit të cilat i kemi mësuar këtë javë. Ditën e Hënë, folëm për Danielin dhe shokët e tij, sesi i morën nga vendi i tyre dhe i detyruan të punonin për Mbretin Nebukadnesar. Njerëzit u përpoqën t'i thoshin Danielit dhe shokëve të tij që të mos i bindeshin Perëndisë dhe të hanin gjëra që nuk duhej t'i hanin. Danieli sugjeroi që të hanin vetëm perime dhe të mbështetej tek Perëndia si trajneri i tij. Udhëheqësi e dëgjoi dhe Danieli bashkë me shokët e tij dukeshin më të shëndetshëm se gjithë të tjerët!

Ditën e Hënë folëm gjithashtu sesi Perëndia jo vetëm që i tregoi Danielit ëndrrën e mbretit, por i tregoi gjithashtu sesi ta interpretonte kuptimin e saj! Perëndia ishte trajneri i tyre dhe kur e vendosën besimin e tyre në Perëndinë, Ai veprroi për Danielin. Diskutuam sesi ne u krijuam prej Perëndisë për të qenë në një marrëdhënie me Të dhe në ekipin e Tij.

Ditën e Martë, pamë shokët e Danielit dhe sesi ata u desh të ishin të guximshëm! Ata i urdhëruan të binin përmbys para statujës që kishte ngritur Nebukadnesari. Edhe pse u përballën me dënimin me vdekje në furrën e zjarrtë ata u treguan të guximshëm dhe në vend që të mëkatonin iu bindën Perëndisë. Folëm gjithashtu sesi ne të gjithë bëjmë gjëra që e trishtojnë Perëndinë. Këto gjëra i quajmë mëkat.

Ditën e Mërkurë mësua për Nebukadnesarin dhe për betejën e tij me krenarinë! Mësua që mëkati kishte pasoja, por Perëndia është gjithmonë i gatshëm të na falë. Nebukadnesari pa në ëndërr një pemë të madhe dhe sesi ajo do të pritej nëse nuk do t'ia jepte lavdinë Perëndisë. Pamë gjithashtu që Nebukadnesari nuk ia vuri veshin interpretimit të Danielit dhe përfundoi duke ngrënë barin si qetë dhe duke u endur lart e poshtë! Kur Nebukadnesari ishte i gatshëm t'i kërkonte falje Perëndisë, Perëndia i ktheu gjithçka. Kemi mësuar që kur jemi të gatshëm të kërkojmë falje Perëndia është gjithmonë i gatshëm të na falë. Kur besojmë që Jezusi është e vetmja mënyrë që mëkatet tona të falen Perëndia e ripërtërin marrëdhënien tonë me Të!

Dje folëm sesi Danieli besoi që Perëndia do ta shpëtonte! Danielit i thanë që nuk mund t'i lutej më Perëndisë ndryshe do të hidhej në gropën e luanëve. A dëgjoi Danieli dhe a besoi që Perëndia do kujdesej për të? Ai besoi dhe u lut gjithsesi. Kur mbreti e mësoi këtë gjë, Danielin e hodhën në gropën e luanëve për gjithë natën. Danieli doli në mëngjes pa asnjë gërvishtje! Folëm gjithashtu sesi besimi në Jezusin është e vetmja mënyrë që ne mund të shpëtohem nga mëkati ynë dhe të kemi një marrëdhënie me Të përgjithmonë!

Danieli ishte këshilltar në shërbim të tre mbretërve të ndryshëm. Ai kishte shumë përgjegjësi, por një nga përgjegjësitë më të rëndësishme që kishte ai ishte t'i besonte Perëndisë. Nëse ju kujtohet, Danieli ishte Jude. Ai jetonte në Izrael kur ishte djalë i vogël, por Mbreti Nebukadnesar e pushtoi Izraelin dhe e çoi Danielin dhe shokët e tij larg në Babiloni. Megjithatë, Perëndia bëri një premtim që gjërat nuk do ishin gjithmonë kaq keq, dhe që një ditë populli Jude mund të kthehej në vendin e vet.

Për popullin Jude ishte e vështirë ta besonin Perëndinë, ashtu sikurse është e vështirë që edhe ne t'i besojmë Atij kur kalojmë kohë të vështira. Danieli pati mundësi të fitonte mbi pengesat që i dolën përpara për shkak se shpresonte që Perëndia do bënte atë që kishte premtuar. Një mënyrë sesi Perëndia ia tregoi Danielit premtimet e tij ishte përmes ëndrrave. Le të shohim një nga ëndrrat e Danielit për të mësuar se çfarë i premtoi Perëndia.

Në fillim ëndrra e Danielit duket paksa e çuditshme.

Lexoni Danieli 7:2-3

Çfarë është kaq e veçantë në një ëndërr me katër kafshë? Perëndia po i tregonte Danielit çfarë do ndodhte në të ardhmen. Katër mbretëri do ngriheshin dhe binin njëra pas tjetrës. Katër bishat ishin shumë të frikshme. Ato shkakton shumë shkatërrim dhe dhimbje. Edhe pse këto mbretëri ishin të mëdha dhe të frikshme, ato nuk do të kishin mundësi ta shkatërronin përfundimisht premtimin e Perëndisë për popullin që ishte në ekipin e Tij.

Nëse ndiqni lajmet sado pak, e dini që ka njerëz të pushtetshëm që u shkaktojnë dhimbje të tjerëve. Edhe nëse nuk i shihni lajmet, njihni njerëz që i lëndojnë të tjetër apo që bëjnë zgjedhje që shkaktojnë dhimbje. Çfarë mund të bëjmë kur jemi të frikësuar nga gjithë gjërat e këqija që shohim përreth nesh?

Ideja kryesore për sot është që Perëndia na ka dhënë të gjithëve ne shpresë për të ardhmen. Nëse jemi në ekipin e Perëndisë atëherë kemi shpresë për të ardhmen e cila na ndihmon të triumfojmë tani dhe përgjithmonë.

Ku mund të shohim për të gjetur shpresë? Në Bibël! Këtu kemi një sërë premtimesh të Perëndisë të shkruara për ne, sesi një ditë Perëndia do ta heqë qafe vdekjen dhe çdo ligësi, si dhe do të fshijë lotët nga sytë tanë.

Ndryshe nga mbretëritë që sunduan me dhunë, Mbretëria e Perëndisë do jetë e drejtë dhe për të gjithë njerëzit, nuk ka rëndësi se nga janë, çfarë gjuhe flasin apo si duken. Ne do të jemi përgjithmonë pjesë e Mbretërisë së Perëndisë.

Lexoni Danieli 7:13-14

Jezusi do jetë ai që do ta bëjë çdo gjë si duhet, dhe Mbretëria e Tij do zgjatë përgjithmonë.

Gjërat nuk do jenë gjithmonë të lehta. Do ketë gjithmonë nga ata që do përpiqen të na lëndojnë apo të na shkaktojnë dhimbje, dhe gjithmonë do ketë gjëra të frikshme në botë.

Lexoni Danieli 7:25-27

Danieli pa një vizion për një mbretëri që do përpiqet t'i lëndojë njerëzit e Perëndisë por në fund Perëndia do jetë fitimtar. A e dalluat premtimin e mrekullueshëm që Perëndia ka për ne? Mbretëria e Perëndisë do jetë edhe e jona. Përfundimisht, do të triumfojmë mbi çdo gjë dhe do jemi përgjithmonë pjesë e Mbretërisë së Perëndisë.

Në jetën tonë do kalojmë sprova të ndryshme, megjithatë Perëndia gjithmonë ka për të patur një vend për ne. Mund të jemi të sigurt duke ditur që Perëndia At ka triumfuar përmes Birit të Tij Jezusit dhe tani ne përfetojmë fitoren e Tij. Shpresa jonë është që Jezusi e ka mundur mëkatën dhe vdekjen përmes jetës së tij të përsosur, vdekjes dhe ringjalljes së tij.

The logo features the words "HIGH" and "POWER" in a bold, dark red, sans-serif font. "HIGH" is positioned above "POWER". A stylized, dark red swoosh or lightning bolt graphic extends from the left side of the "H" in "HIGH" and curves under the "P" in "POWER". The entire logo is set against a bright yellow background with a sunburst pattern of radiating lines.

HIGH POWER

Base Sports Ministry
708 Broadway, Suite 201
Tacoma, WA 98402
(866) 238-0163
www.basesports.org